Banka e Shqipërisë

RAPORTI TREMUJOR I POLITIKËS MONETARE

Gusht 2015

(DEKLARATA E POLITIKËS MONETARE
PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2015)

* *Analiza ekonomike dhe monetare në këtë raport mbështetet mbi të dhënat statistikore dhe cilësore të disponuara deri në datën 20 korrik 2015.*

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 310 kopje

P Ë R M B A J T J A

OBJEKTIVI 7

1. FJALA E GUVERNATORIT 8

2. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE OBJEKTIVI I BANKËS SË SHQIPËRISË 11

3. TREGJET FINANCIARE DHE ZHVILLIMET MONETARE 14

3.1. Zhvillimet në tregjet financiare 14
3.2. Normat e interesit të depozitave dhe kushtet e financimit 17
3.3. Kreditimi i ekonomisë 20
3.4. Ecuria e treguesve monetarë 22

4. INFLACIONI DHE RRITJA EKONOMIKE 25

4.1. Ambienti i jashtëm i ekonomisë 25
4.2. Prodhimi i brendshëm bruto dhe ecuria e kërkesës agregate 30
4.3. Gjendja ciklike e ekonomisë 46
4.4. Ecuria e inflacionit 48

SHTOJCA STATISTIKORE 53

H A P Ë S I R A I N F O R M U E S E

Hapësirë informuese 1.	*Rezultatet e vrojtimit të aktivitetit kreditues, tremujori i dytë 2015*	*19*
Hapësirë informuese 2.	*Prodhimi i brendshëm bruto tremujor, komponentët e kërkesës agregate dhe rëndësia për politikën monetare*	*32*
Hapësirë informuese 3.	*Ecuria e çmimeve në tregun e banesave*	*36*
Hapësirë informuese 4.	*Zhvillimet në bilancin e pagesave në tremujorin e parë të vitit 2015*	*45*
Hapësirë informuese 5.	*Ekspozimi i ekonomisë shqiptare ndaj zhvillimeve në Greqi*	*47*

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

4. Inflacioni dhe rritja ekonomike

Tabelë 1.	*Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë*	*26*
Tabelë 2.	*Tregues ekonomikë për vendet e rajonit*	*28*
Tabelë 3.	*Tregues të bilancit të pagesave*	*46*
Tabelë 4.	*Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)*	*49*

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

2. Stabiliteti i çmimeve dhe objektivi i Bankës së Shqipërisë

Grafik 1. Normat e interesit në ekonomi 11
Grafik 2. Inflacioni, norma bazë dhe objektivi (majtas). Hendeku i prodhimit dhe inflacioni bazë (djathtas) 12

3. Tregjet financiare dhe zhvillimet monetare

Grafik 3. Operacionet e tregut të hapur të BSH-së (majtas) dhe ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar (djathtas) 15
Grafik 4. Yield-et e titujve të borxhit publik në tregun primar 15
Grafik 5. Ndryshimet vjetore të indekseve të kursit nominal dhe real të këmbimit; ecuria e kursit Eur/Lek dhe Usd/Lek 16
Grafik 6. Normat e interesit të depozitave të reja 17
Grafik 7. Normat e interesit për kredinë e re 18
Grafik 8. Standardet e kredisë (balanca neto) 19
Grafik 9. Kërkesa për kredi (balanca neto) 19
Grafik 10. Kreditimi i ekonomisë 20
Grafik 11. Kreditimi i bizneseve 21
Grafik 12. Kreditimi i individëve 22
Grafik 13. Zhvillimet në treguesit monetarë 23
Grafik 14. Zhvillimet në depozita 23

4. Inflacioni dhe rritja ekonomike

Grafik 15. Indeksi i përbërë i prodhimit dhe PBB-ja tremujore (majtas) dhe ecuria e treguesve të vrojtimit për biznesin, konsumatorët dhe ndjesinë ekonomike (djathtas) 26
Grafik 16. Ndryshimet vjetore të çmimeve bazë 29
Grafik 17. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore 29
Grafik 18. Ecuria e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare 30
Grafik 19. Ecuria vjetore dhe tremujore e PBB-së 31
Grafik 20. Prodhimi i brendshëm bruto sipas sektorëve në ekonomi 32
Grafik 21. Prodhimi i brendshëm bruto sipas shpenzimeve 33
Grafik 22. Prodhimi i brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe treguesit e besimit 34
Grafik 23. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në industri dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve 35
Grafik 24. Ecuria e vlerës së shtuar dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në ndërtim 36
Grafik 25. Indeksi i çmimit të banesave dhe raporti i tij ndaj indeksit të qirasë së banesave 36
Grafik 26. Raporti çmim/qira dhe tregues nga vrojtimi i aktivitetit kreditues 37
Grafik 27. Kontributet e degëve dhe normat e shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorin e shërbimeve 37
Grafik 28. Struktura e kërkesës agregate (kontribute në ndryshimin vjetor të PBB-së) dhe treguesi i ndjesisë ekonomike, TNE (mesatare afatgjatë=100) 39
Grafik 29. Ecuria e konsumit privat dhe besimit në sektorin e tregtisë 40
Grafik 30. Tregues të tërthortë për ecurinë e konsumit privat në tremujorin e dytë 40
Grafik 31. Ecuria e formimit bruto të kapitalit fiks, ndryshime vjetore 40
Grafik 32. Tregues afatshkurtër të investimeve private për tremujorin e dytë 41
Grafik 33. Orientimi i politikës fiskale, i përafruar nga ndryshimi i deficitit primar 41
Grafik 34. Ndryshimi vjetor i totalit të shpenzimeve sipas kontributeve të zërave kryesorë (majtas), pesha e përbërësve kryesorë të shpenzimeve tek shpenzimet totale (djathtas) 42
Grafik 35. Ndryshimi vjetor i të ardhurave sipas kontributeve të zërave kryesorë (majtas), dhe ndryshimet vjetore të zërave kryesorë të të ardhurave (djathtas) 43
Grafik 36. Shuma rrëshqitëse 12-mujore e deficitit (majtas) dhe instrumentet e financimit të tij, në mld lekë (djathtas) 43
Grafik 37. Kontributi i eksporteve neto në kërkesën agregate (në pikë përqindje) 44

Grafik 38. Orientimi i importeve dhe eksporteve sipas kategorive (vlera në milionë lekë) 44
Grafik 39. Tregues të gjendjes ciklike të ekonomisë 47
Grafik 40. Kontributet sipas kategorive ushqimore dhe joushqimore në inflacionin vjetor total 49
Grafik 41. Prirjet afatgjata (majtas) dhe afatshkurtra të inflacionit (djathtas) 50
Grafik 42. Ndryshimet vjetore mesatare të produktivitetit, të kostove të punës dhe të prodhimit 50
Grafik 43. TPHI dhe kontributet e përbërësve të tij (majtas); kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm në atë total vjetor (djathtas) 51
Grafik 44. Pritjet inflacioniste nga agjentë të ndryshëm të ekonomisë 52

OBJEKTIVI

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Nxitja e investimeve afatgjata, ruajtja e fuqisë blerëse të parasë, rritja e eficiencës së shpërndarjes së fondeve në ekonomi dhe mbështetja e stabilitetit financiar, janë disa nga përfitimet e një mjedisi ekonomik të karakterizuar nga stabiliteti i çmimeve. Ky stabilitet është kontributi më i madh që banka qendrore mund të japë në mbështetje të një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Në përputhje me strategjinë e miratuar në Dokumentin e Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë angazhohet në arritjen dhe ruajtjen e inflacionit vjetor në nivelin 3.0% në një periudhë afatmesme. Shpallja e objektivit sasior për inflacionin synon ankorimin e pritjeve të agjentëve ekonomikë dhe uljen e primeve të rrezikut.

Në përmbushje të këtij qëllimi dhe për të forcuar transparencën e saj, Banka e Shqipërisë përgatit dhe publikon çdo tre muaj Raportin e Politikës Monetare. Ai është instrumenti kryesor i komunikimit të politikës monetare me publikun. Raporti paraqet një tablo gjithëpërfshirëse të zhvillimeve më të fundit makroekonomike dhe të faktorëve që priten të ndikojnë në ecurinë e çmimeve të konsumit në vend.

Raporti i Politikës Monetare, gusht 2015 i referohet Deklaratës së Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2015, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 53, datë 06.08.2015. Analiza ekonomike dhe monetare në këtë raport mbështetet mbi të dhënat më të fundit në dispozicion, deri më 20 korrik 2015.

1. FJALA E GUVERNATORIT

Zhvillimet ekonomike dhe financiare kanë rezultuar përgjithësisht në përputhje me pritjet tona afatmesme. Shmangiet nga këto pritje dhe luhatjet që kanë pësuar disa tregues ekonomikë e financiarë, gjatë gjashtëmujorit të parë, vlerësohet të jenë kalimtare. Rritja ekonomike pritet të përshpejtohet në vitin në vazhdim, duke iu afruar potencialit të vet dhe duke shtuar presionet inflacioniste në ekonomi. Inflacioni pritet të rritet gradualisht, duke iu afruar objektivit 3.0% brenda intervalit afatmesëm. Në përputhje me këto parashikime, me shqyrtimin e këtij raporti, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se kushtet monetare janë të përshtatshme për përmbushjen e objektivit të stabilitetit të çmimeve dhe vendosi ta mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 2.0%.

- Inflacioni parashikohet të rritet gradualisht drejt objektivit gjatë dy viteve të ardhshme.

Inflacioni mesatar vjetor i tremujorit të dytë rezultoi në nivelin 1.8%. Luhatjet e inflacionit gjatë gjashtë muajve të parë të vitit kanë reflektuar ecurinë e çmimeve të ushqimeve të papërpunuara. Këto të fundit kanë pasur luhatje të larta në periudhën shkurt – prill të këtij viti, edhe për shkak të përmbytjeve në disa nga zonat e ulëta të vendit.

Nga këndvështrimi makroekonomik, rritja e ngadaltë e çmimeve pasqyron efektin e një kërkese të dobët agregate si dhe çmimet relativisht të ulëta në tregjet botërore. Ndikimi i këtyre faktorëve do të vazhdojë të jetë i pranishëm në horizontin afatshkurtër. Inflacioni mesatar i vitit 2015 pritet të luhatet rreth nivelit 2%. Parashikimet e Bankës së Shqipërisë sugjerojnë se inflacioni do të vazhdojë të rritet më tej gjatë dy viteve të ardhshme dhe të kthehet në mënyrë të qëndrueshme në objektivin tonë prej 3%, rreth fundit të vitit 2017.

- Kthimi i inflacionit në objektiv do të mbështetet nga një gjallërim gradual i ekonomisë në vitet në vijim.

Në masën më të madhe, parashikimi mbi ecurinë e inflacionit në dy vitet në vijim mbështetet në projeksionet tona për një rritje progresive të ekonomisë dhe për një shfrytëzim më të plotë të kapaciteteve prodhuese gjatë viteve të ardhshme.

Të dhënat më të fundit ekonomike janë në linjë me vlerësimet e mësipërme. Rritja ekonomike e vitit 2015 pritet të jetë më e lartë se ajo e një viti më parë. Sipas të dhënave të Instat-it, tremujori i parë shënoi një rritje vjetore të aktivitetit ekonomik prej 2.8%. Kjo normë ishte më e lartë se pritjet tona dhe pasqyron

kryesisht rritjen e investimeve dhe të eksporteve neto. Të dhënat indirekte të disponuara, sugjerojnë për norma të ngjashme rritjeje edhe gjatë tremujorit të dytë.

Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se gjysma e dytë e vitit mund të shënojë ritme më të ngadalta rritjeje, si pasojë e ndikimit të mundshëm negativ të ngjarjeve në Greqi. Megjithatë, marrëveshja e arritur në muajin korrik 2015, është pikënisje për normalizimin e situatës në vendin fqinj.

Për rrjedhim, efektet më të mundshme në Shqipëri do të përqendrohen në rënien e përkohshme të aktivitetit tregtar dhe të remitancave, pa cënuar aktivitetin e sistemit financiar. Si të tilla, këto efekte pritet të jenë kalimtare.

Nga këndvështrimi i politikës monetare, rëndësi të veçantë kanë projeksionet për rritjen ekonomike dhe inflacionin në një periudhë afatmesme. Ekonomia shqiptare parashikohet të ketë ritme më të larta rritjeje në dy vitet e ardhshme. Bilancet e sektorit bankar dhe privat, ambienti i jashtëm ekonomik dhe klima e përgjithshme e biznesit, pritet të përmirësohen në këtë periudhë. Këto zhvillime do të mbështesin zgjerimin e kërkesës së brendshme dhe të jashtme.

- Rritja ekonomike do të mbështetet edhe nga kushte të favorshme financimi.

Për një periudhë relativisht të gjatë kohe, kahu i politikës monetare ka qenë lehtësues. Ulja e vazhdueshme e normës bazë të interesit, përcjellja në publik e angazhimeve të Bankës së Shqipërisë për të qëndruar në këtë territor edhe në të ardhmen, reduktimi i pritur i primeve të rrezikut, si dhe përmirësimi i bilanceve dhe treguesve të shëndetit financiar të sistemit bankar, janë premisa për një lehtësim të mëtejshëm të kushteve të financimit të ekonomisë.

Tregjet financiare shqiptare vazhdojnë të karakterizohen nga një situatë e mirë likuiditeti. Normat e interesit të kredisë për ekonominë dhe normat e interesit të letrave me vlerë të qeverisë janë pranë minimumeve historike. Në përgjigje të tyre, kreditimi në lekë ka shënuar rritje, ndërsa kostot e shërbimit të borxhit të sektorit privat dhe publik kanë shënuar rënie.

Zhvillimet e kreditimit shfaqen më pozitive në tremujorin e dytë. Kështu, kredia për sektorin rezident privat shënoi një rritje vjetore prej 2.4% në muajin maj, një normë rritjeje kjo më e lartë se ajo e regjistruar në fund të tremujorit të parë. Rritja e kredisë është mbështetur nga rritja vjetore me 7.5% e kredisë në lekë, ndërkohë që portofoli i kredisë në valutë ka rënë me 0.7%. Në aspektin sektorial, kreditimi i individëve vazhdon të shënojë norma më të larta rritjeje se kreditimi i bizneseve.

Banka e Shqipërisë pret një përmirësim gradual të kreditimit në pjesën e mbetur të vitit, por një përmirësim progresiv të tij në dy vitet e ardhshme. Ky përmirësim do të mbështetet nga rritja e kërkesës, nga normat e ulëta të

interesit dhe nga reduktimi i rrezikut të perceptuar në tregjet e brendshme dhe të huaja financiare. Në veçanti, ulja e pritur e kërkesës së qeverisë për financim në tregun e brendshëm do të krijojë më shumë hapësira për rritjen e kreditimit të sektorit privat.

- Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës konstaton se suksesi i planit të masave për reduktimin e kredive me probleme do të rrisë gatishmërinë e bankave në kredidhënie.

Portofoli i kredive me probleme u reduktua me rreth 2 pikë përqindje gjatë tremujorit të dytë, kryesisht në përgjigje të masave rregullatore që mori Banka e Shqipërisë në fillim të këtij viti. Ky është një sinjal inkurajues në drejtim të pastrimit të bilancit të sistemit bankar. Megjithatë, sipas planit ndërinstitucional të aprovuar të masave, ai duhet të mbështetet nga përmirësime ligjore dhe nënligjore, të cilat parandalojnë rritjen e kredive me probleme dhe mundësojnë një zgjidhje të shpejtë të tyre. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë sjell në vëmendje të të gjitha agjencive publike të përfshira në këtë projekt, nevojën për zbatimin e shpejtë dhe me rigorozitet të angazhimeve tona të përbashkëta.

- Përmbushja e objektivave të Bankës së Shqipërisë do të kërkojë ruajtjen e kahut lehtësues të politikës monetare edhe për disa tremujorë në vazhdim.

Ruajtja e stimulit monetar është konsistent me pritjet për një politikë fiskale konsoliduese gjatë kësaj periudhe. Sikurse e kemi thënë dhe më parë, konsolidimi fiskal redukton primet e rrezikut të vendit dhe lehtëson transmetimin e politikës monetare në tregjet financiare.

Duke u nisur nga informacioni i disponuar, si dhe në bazë të vlerësimeve e parashikimeve tona, Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se nivelet aktuale të stimulit monetar do të ruhen të paktën edhe përgjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2016. Nga ana tjetër, balanca e rreziqeve mbetet e zhvendosur në kahun e poshtëm. Banka e Shqipërisë po monitoron me kujdes situatën në Greqi dhe ndikimin e saj në ekonominë shqiptare.

Në rast se zhvillimi i ngjarjeve do të japë një ndikim negativ të fortë e të zgjatur në kohë mbi ekonominë shqiptare, Banka e Shqipërisë disponon instrumentet e duhura dhe mbetet e gatshme të marrë masa shtesë për përmbushjen e objektivave të saj.

Në përfundim, Këshilli Mbikëqyrës rithekson edhe një herë nevojën për vazhdimin dhe përshpejtimin e reformave strukturore. Ndër të tjera, këto reforma duhet të synojnë përmirësimin e qëndrueshëm të klimës së biznesit, rritjen e produktivitetit dhe të konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare, nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja, si dhe rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike e financiare të vendit.

2. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE OBJEKTIVI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Politika monetare lehtësuese e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka synuar kthimin e inflacionit në objektiv dhe ankorimin e pritjeve inflacioniste rreth tij. Në terma më konkretë, kjo politikë synon: (i) të ulë kostot e financimit në ekonomi, duke stimuluar kërkesën nëpërmjet rritjes së konsumit dhe të investimeve; (ii) të përmirësojë fluksin e parasë të agjentëve ekonomikë, duke çliruar fonde financiare të cilat mund të përdoren po ashtu për rritje konsumi e investimesh; dhe, (iii) të mbajë të ankoruara pritjet inflacioniste të agjentëve ekonomikë. Gjithashtu, një politikë monetare lehtësuese stimulon përmirësimin e bilancit tregtar dhe rritjen e kërkesës agregate, nëpërmjet efektit në kursin e këmbimit.

Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare lehtësuese gjatë viteve të fundit, në përgjigje të dobësisë ciklike të ekonomisë shqiptare dhe të vlerave të inflacionit nën objektiv. Intensiteti i stimulit monetar është rritur në mënyrë progresive, nëpërmjet uljeve të vazhdueshme të normës bazë të interesit dhe zbatimit të operacioneve injektuese të likuiditetit. Gjithashtu, duke synuar rritjen e efektivitetit të politikës monetare, Banka e Shqipërisë ka komunikuar angazhimin e saj për ruajtjen e kahut lehtësues të politikës monetare për disa tremujorë.

Grafik 1. Normat e interesit në ekonomi



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lehtësimi i politikës monetare është reflektuar në reduktimin e kostove të financimit të sektorit publik e privat. Në përgjigje të tyre, kreditimi në lekë ka shënuar rritje, ndërsa kostot e shërbimit të borxhit të sektorit privat dhe publik kanë shënuar rënie. Angazhimi për ruajtjen e një politike monetare stimuluese

edhe në të ardhmen ka ndihmuar në kontrollin e pritjeve për inflacionin, duke frenuar rritjen e normave reale të interesit dhe duke stimuluar rritjen e shpenzimeve private. Të dy këto kanale kanë mbështetur rritjen e konsumit dhe të investimeve, të cilat kanë formuar edhe burimin kryesor të rritjes ekonomike gjatë dy viteve të fundit. Nga ana tjetër, politika monetare lehtësuese ka frenuar tendencat mbiçmuese të kursit të këmbimit dhe ka ndihmuar në përmirësimin e bilancit tregtar.

Megjithatë, mekanizmi i transmetimit të politikës monetare mbetet ende i dobët, si pasojë e primeve të larta të rrezikut në ekonominë e brendshme dhe atë të jashtme. Kërkesa agregate nuk është e mjaftueshme për të siguruar kthimin e ekonomisë në ekuilibër dhe presionet e përgjithshme inflacioniste janë të dobëta. Këtë vlerësim e mbështesin edhe të dhënat e fundit ekonomike e monetare.

Inflacioni erdhi në rënie gjatë tremujorit të dytë, duke shënuar një vlerë mesatare prej 1.8%. Ngadalësimi i tij u shkaktua kryesisht nga çmimet më të ulëta të ushqimeve, si pasojë e rritjes së ofertës vendase të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale në muajt maj e qershor. Në aspektin makroekonomik, rënia e inflacionit në këtë tremujor, vlerësohet të ketë ardhur si pasojë e faktorëve kalimtarë të ofertës. Megjithatë, inflacioni bazë vazhdon të mbetet i ulët, në reflektim të faktit se aktiviteti ekonomik në vend vazhdon të mbetet nën nivelin e tij potencial.

Grafik 2. Inflacioni, norma bazë dhe objektivi (majtas). Hendeku i prodhimit dhe inflacioni bazë (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Ekonomia shqiptare u rrit me 2.8% në tremujorin e parë të vitit, e mbështetur nga rritja e investimeve dhe e kërkesës së huaj neto. Rritja ekonomike e kësaj periudhe ishte disi më e lartë se pritjet tona, por ajo nuk ka ndryshuar vlerësimet për hendekun negativ të prodhimit dhe parashikimet tona afatshkurtra e afatmesme.

Ekonomia shqiptare pritet të shënojë një trajektore rritëse gjatë horizontit afatmesëm. Rritja ekonomike e vitit 2015 pritet të jetë në nivele mesatare më të ulëta, krahasuar me tremujorin e parë, duke reflektuar edhe disa goditje të pritura nga zhvillimet në Greqi në gjysmën e dytë të vitit. Megjithatë, rritja ekonomike parashikohet të mbështetet në një bazë më të gjerë dhe të vijë në përmirësim gjatë vitit 2016 e më tej. Kushtet financiare, bilancet e sektorit financiar dhe privat, si dhe ambienti i jashtëm pritet të vijnë në përmirësim, duke ushqyer rritjen e kërkesës së brendshme dhe të jashtme. Inflacioni mesatar i vitit 2015 pritet të luhatet rreth nivelit 2%. Ai pritet të kthehet në objektiv brenda periudhës afatmesme, në linjë edhe me përmirësimet e pritura të aktivitetit ekonomik.

Në përputhje me këto parashikime, Banka e Shqipërisë vlerëson se kthimi i inflacionit në objektiv do të kërkojë ruajtjen e kahut lehtësues të politikës monetare edhe për disa kohë. Ruajtja e kahut dhe intensitetit aktual të stimulit të fortë monetar, do të ndihmojë në nxitjen e kërkesës agregate dhe kthimin e ekonomisë në ekuilibër e të inflacionit në objektiv. Ai bëhet edhe më i nevojshëm në prani të pritjeve për një politikë fiskale konsoliduese gjatë kësaj periudhe, si dhe në prani të një balance rreziqesh të zhvendosur në kahun e poshtëm.

3. TREGJET FINANCIARE DHE ZHVILLIMET MONETARE

Ecuria e tregjeve financiare dhe e treguesve monetarë ka reflektuar zhvillimet e përgjithshme ekonomike. Tregjet financiare vazhdojnë të karakterizohen nga një situatë e mirë likuiditeti dhe në përgjigje të politikës monetare lehtësuese, normat e interesit mbeten në nivele të ulëta historike. Megjithatë, situata në Greqi është reflektuar në luhatje të shtuara të normave të interesit në muajin qershor. Ecuria e kursit të këmbimit të lekut ka qenë përgjithësisht e qëndrueshme, me një tendencë nënçmimi ndaj dollarit amerikan.

Kushtet e kreditimit u lehtësuan në tremujorin e dytë, por ecuria e kredisë vazhdon të mbetet e dobët. Ajo ndikohet si nga kërkesa e pakët për kredi, ashtu edhe nga politikat konservatore dhe dëshira e ulët për rrezik e sistemit bankar. Zgjerimi i mjeteve monetare mbetet i ulët dhe nuk sinjalizon për presione të larta inflacioniste. Struktura e mjeteve monetare vazhdon të zhvendoset drejt ekstremit të spektrit të likuiditetit. Gjatë gjysmës së parë të vitit, ka vazhduar lëvizja drejt llogarive rrjedhëse dhe parasë fizike në njërin kah dhe në kahun tjetër, një zhvendosje drejt depozitave me afat mbi dy vjet dhe letrave me vlerë të qeverisë.

Banka e Shqipërisë pret një situatë të ngjashme edhe për pjesën e mbetur të vitit e në vazhdim. Pavarësisht luhatjeve, normat e interesit pritet të mbeten në nivele të ulëta historike, ndërsa standardet e kreditimit pritet të vijnë në përmirësim. Kreditimi pritet të ketë një rikuperim të lehtë gjatë vitit 2015 dhe një përmirësim më të ndjeshëm gjatë vitit të ardhshëm.

3.1. ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE

TREGU NDËRBANKAR

Vëllimi mesatar i tregtuar në tregun ndërbankar rezultoi 7.5 miliardë lekë në tremujorin e dytë ose 1.2 miliardë lekë më pak nga tremujori i kaluar. Transaksionet midis bankave kanë afate të shkurtra, kryesisht një dhe shtatëditore. Kahu lehtësues i politikës monetare dhe situata e favorshme e likuiditetit janë reflektuar në rënie të normave të interesit në këtë treg. Që prej uljes së fundit të normës bazë në muajin janar, interesat e transaksioneve ndërbankare kanë qëndruar kryesisht poshtë normës bazë. Ato janë luhatur më pak në tremujorin e dytë.[1] Norma mesatare e interesave njëditore rezultoi 1.92% ose 0.10 pikë përqindje më poshtë nga ajo e tremujorit të mëparshëm. Ajo shtatëditore zbriti në 1.97%, nga 2.05% tre muaj më parë.

[1] *Devijimi standard i interesit ditor në tregun ndërbankar për tremujorin e dytë rezultoi 0.084, nga 0.194 në tremujorin paraardhës.*

Me gjithë përmirësimet e viteve të fundit, tregu ndërbankar vijon të ketë peshë të ulët në aktivet e sistemit bankar dhe të karakterizohet nga shpërndarje strukturore jo e njëtrajtshme e likuiditetit.[2]

Grafik 3. Operacionet e tregut të hapur të BSH-së (majtas) dhe ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

TREGU PRIMAR

Tremujori i dytë i vitit 2015 është karakterizuar nga një prirje rënëse e *yield*-eve për të gjitha maturitetet. Pritjet për një kërkesë më të ulët për financim nga ana e qeverisë krijuan presione rënëse tek *yield*-et. Pjesëmarrja në ankande ka qenë përgjithësisht e lartë, e mbështetur edhe nga kërkesa e individëve. Prej më se një viti, diferenca pozitive e kthimit nga investimi në letra me vlerë,

Grafik 4. *Yield*-et e titujve të borxhit publik në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[2] *Vëllimi i huamarrjes në tregun ndërbankar llogaritet të jetë rreth 1.0% e totalit të aktiveve të sistemit bankar. Tregu është i segmentuar dhe, për shkak të kufizimeve në ekspozime, administrimi i likuiditetit është shpesh joefikasht.*

krahasuar me kthimin nga investimi në depozita me afat, ka shtyrë individët të rrisin preferencën për instrumentet afatgjata.

Yield-et e bonove të thesarit 3- dhe 6-mujore kanë shënuar rënie në norma minimale historike.[3] *Yield*-i 12-mujor zbriti në vlerën 3.25% në javën e parë të korrikut ose 0.32 pikë përqindje më pak se një tremujor më parë. Gjithashtu, ankandet e obligacioneve në muajt prill dhe maj treguan rritje të kërkesës për këto instrumente, gjë e cila ndikoi në uljen e *yield*-eve të tyre. *Yield*-i 5-vjeçar fiks u ul me 0.20 pikë përqindje (në 6.45%), ndërsa *yield*-i 10-vjeçar u ul me 0.32 pikë përqindje (në 8.93%). Ky i fundit nuk kishte pësuar rënie që prej emetimit të parë të tij në vitin 2013.

Rezultatet e ankandeve në muajin qershor sugjerojnë frenim të prirjes rënëse të *yield*-eve. Ngjarjet në Greqi mund të kenë rritur pasiguritë e tregut lidhur me rifinancimin e Eurobond-it shqiptar në tregun ndërkombëtar, duke ndikuar këtë zhvillim.[4]

TREGU VALUTOR

Monedha vendase ka vijuar të nënçmohet ndaj shportës së monedhave të huaja kryesore në tremujorin e dytë. Indeksi i kursit nominal efektiv të këmbimit (KNEK)[5] u nënçmua mesatarisht me 3.0% në terma vjetorë. Kjo ecuri u diktua plotësisht nga dobësimi i monedhës vendase ndaj dollarit amerikan. Presionet nënçmuese kanë ardhur duke u dobësuar në fund të periudhës tremujore.

Grafik 5. Ndryshimet vjetore të indekseve të kursit nominal dhe real të këmbimit; ecuria e kursit Eur/Lek dhe Usd/Lek



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[3] *Yield-et 3-, 6- dhe 12-mujore shënuan përkatësisht 2.77%, 2.97% dhe 3.25% deri më 10 korrik, nga 3.06%, 3.23% dhe 3.57% në fund të muajit mars 2015.*

[4] *Në "Strategjinë afatmesme të menaxhimit të borxhit publik 2015-2017", Ministria e Financave shprehet se një pjesë e financimit të deficitit buxhetor për vitin 2015 do të mbulohet me kredi të huaj dhe rifinancim të Eurobond-it në tregjet ndërkombëtare (www.financa.gov.al). Nëse realizohet, kjo do të ulë kërkesën për financim nga tregu i brendshëm.*

[5] *Kursi nominal efektiv i këmbimit (ang. NEER) llogaritet kundrejt monedhave të pesë partnerëve tregtarë kryesorë, të cilët janë Italia, Greqia, Gjermania, Turqia dhe Kina. Një rritje e tij nënkupton nënçmim të lekut.*

Në terma realë, është vënë re një nënçmim më i përmbajtur i lekut (2.0% në bazë vjetore). Shkak për këtë kanë qenë normat e inflacionit më të larta në vend, krahasuar me ato të regjistruara në shtetet e Eurozonës. Indeksi i presioneve në tregun valutor[6] dikton një rritje të lehtë të presioneve në muajt maj dhe qershor, por gjithsesi ai mbetet brenda intervalit historik. Kërkesa për valutë ka rezultuar në rritje deri në muajin qershor. Nga ana tjetër, oferta më e lartë për valutë duket të jetë përqendruar në pjesën e dytë të muajit qershor, në linjë me sezonalitetin e periudhës.

Në terma bilateralë, kursi mesatar i këmbimit Eur/Lek rezultoi në nivelin 140.6 në tremujorin e dytë. Leku shënoi nënçmim të lehtë, si në terma vjetorë (0.4%), ashtu edhe në ato tremujorë (0.3%). Leku është nënçmuar ndaj dollarit amerikan me 24.0% në krahasim me një vit më parë, ndërkohë që është mbiçmuar me 2.0% në terma tremujorë. Zhvillimet e dollarit amerikan në tregjet e huaja valutore kanë gjetur pasqyrim edhe në tregun vendas.[7] Në tremujorin e dytë, raporti mesatar usd/lek ishte 127.2.

3.2. NORMAT E INTERESIT TË DEPOZITAVE DHE KUSHTET E FINANCIMIT[8]

Normat e interesit të depozitave në lekë mbeten pranë niveleve të ulëta historike, ndonëse u karakterizuan nga luhatje gjatë pesë muajve të parë të vitit. Ato pësuan ulje në muajt mars dhe prill, por u rritën - mesatarisht me 0.1

Grafik 6. Normat e interesit të depozitave të reja



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[6] *Indeksi llogaritet si një kombinim linear i ndryshimit vjetor të rezervës ndërkombëtare, indeksit KNEK të shprehur në përqindje dhe indeksit të diferencës së interesave të ponderuar të depozitave në lekë ndaj atyre në dollarë dhe euro. Peshat në këtë indeks janë llogaritur si shpërndarje e përmbysur e serisë mujore të secilit komponent.*

[7] *Sipas Indeksit Nominal të publikuar nga FED, dollari amerikan është forcuar ndaj shportës së monedhave të tjera kryesore me 15% gjatë periudhës gusht 2014-qershor 2015.*

[8] *Të dhënat më të fundit zyrtare për normat e interesit për kreditë dhe depozitat e reja i përkasin muajit maj 2015.*

pikë përqindjeje - në muajin maj. Norma më të larta interesash janë aplikuar për afatet deri në një vit. Në të kundërt, interesat e depozitave në euro vijojnë të ulen. Rënia e përshpejtuar e tyre në dy vitet e fundit është ndikuar nga ruajtja e niveleve të ulëta të interesave në euro në tregjet ndërkombëtare dhe nga tkurrja e kreditimit në këtë monedhë.

Normat e interesit të kredisë në lekë janë shfaqur më të luhatshme gjatë vitit 2015 dhe me tendencë të ndryshme, në varësi të maturitetit dhe qëllimit të përdorimit të kredisë. Interesat afatmesme dhe afatgjata janë ulur lehtë, ndërsa ato afatshkurtra – deri në 1 vit – janë rritur, krahasuar me tremujorin e fundit të vitit të kaluar. Interesi mesatar i ponderuar për kredinë e re në lekë rezultoi 8.28% në periudhën janar-maj, nga 7.87% në tremujorin e fundit të vitit 2014. Ai është rritur veçanërisht në dy muajt e fundit. Në këtë periudhë, kredia e re është dhënë kryesisht për financimin e nevojave të likuiditetit për bizneset dhe ka qenë e përqendruar në pak banka. Interesat për kredi për qëllime konsumi dhe për investime afatgjata kanë rënë, duke mbështetur ecurinë e kredisë për këto kategori.

Grafik 7. Normat e interesit për kredinë e re



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Interesat për kredinë në euro kanë njohur ulje veçanërisht në muajt prill-maj. Interesi mesatar i kredisë në euro llogaritet 5.96% në këtë periudhë, nga 6.31% në tremujorin e parë. Kjo rënie është reflektuar në ngushtimin e diferencës së tyre me indeksin euribor 12-mujor. Bankat zgjeruan marzhet mbi interesin euribor që prej vitit 2013, duke sinjalizuar një qasje më konservatore ndaj kredisë në euro.

Në përgjithësi, bankat vijojnë të aplikojnë kushte financimi më të lehtësuara për individët, ndërsa ruajnë kushte të shtrënguara për bizneset. Këto të fundit janë huamarrësit që shfaqin nivelin më të lartë të kredive me probleme. Për tremujorin e tretë, bankat presin që normat e interesit të ulen, si në monedhën lek, ashtu dhe në atë në euro.

Hapësirë informuese 1. Rezultatet e vrojtimit të aktivitetit kreditues, tremujori i dytë 2015

Rezultatet e vrojtimit të aktivitetit kreditues evidentojnë një lehtësim të standardeve të kredidhënies për bizneset dhe për individët në tremujorin e dytë të vitit 2015. Standardet rezultuan të lehtësuara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si për qëllimin e financimit të investimeve, ashtu dhe për financimin e kapitalit qarkullues. Standardet e aplikuara për kreditë dhënë korporatave mbetën të pandryshuara nga një tremujor më parë. Për kreditë dhënë individëve, standardet u lehtësuan si për ato me qëllim blerjen e banesës, ashtu dhe për ato me qëllim financimin e konsumit.

Grafik 8. Standardet e kredisë (balanca neto)



Burimi: Vrojtimi i aktivitetit kreditues, Banka e Shqipërisë.

Në kahun lehtësues, standardet e kredidhënies për bizneset dhe individët u ndikuan nga gjendja e likuiditetit të bankave, nga mjaftueshmëria e kapitalit, nga konkurrenca në tregun bankar, si dhe nga vendimet e marra nga Banka e Shqipërisë. Kreditë me probleme përfaqësojnë një faktor me kontribut negativ në ecurinë e standardeve të kredidhënies për individë dhe biznese.

Grafik 9. Kërkesa për kredi (balanca neto)



Burimi: Vrojtimi i aktivitetit kreditues, Banka e Shqipërisë.

Politika lehtësuese e kredidhënies u zbatua kryesisht nëpërmjet ngushtimit të marzhit mesatar dhe rritjes së maturitetit maksimal të kredisë.

Kërkesa e bizneseve për kredi u vlerësua në rënie, ndërsa kërkesa e individëve u vlerësua në rritje gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015. Rënia e kërkesës së bizneseve u ndje në madhësi të njëjtë, si për ndërmarrjet e vogla e të mesme, ashtu edhe për korporatat e mëdha. Në të kundërt, kërkesa e individëve rezultoi ndjeshëm e përmirësuar, si për blerje banese, ashtu dhe për financimin e konsumit.

Pritjet për standardet e kredidhënies për bizneset dhe individët paraqiten në kahun lehtësues për tremujorin e tretë të vitit 2015. Kërkesa e individëve për kredi pritet të rritet, ndërsa ajo e bizneseve të jetë e ulët gjatë tremujorit në vazhdim.

3.3. KREDITIMI I EKONOMISË

Kredia për sektorin rezident privat shënoi një rritje vjetore prej 2.4% në tremujorin e dytë, duke qenë më e lartë se norma e rritjes vjetore në tremujorin paraardhës (1.9%).[9] Përmirësimi i normave të rritjes ka reflektuar ecurinë e portofolit të kredisë në monedhë vendase. Njëkohësisht, ai është mbështetur nga rritja e portofolit të kredisë për individë. Zhvillimet në kredi shfaqen më pozitive, krahasuar me një vit më parë, por ato vazhdojnë të karakterizohen nga nivele të ulëta rritjeje. Në një këndvështrim më afatgjatë, kjo ecuri është ndikuar nga kërkesa e ulët e bizneseve për kredi dhe nga politikat konservatore të bankave. Me gjithë përmirësimin afatshkurtër, standardet e kreditimit shfaqen të luhatshme dhe në veçanti për bizneset, mbeten ndjeshëm të shtrënguara krahasuar me 4 vite më parë.

Grafik 10. Kreditimi i ekonomisë*



*Në grafikun majtas, të dhënat paraqesin një mesatare të ponderuar të rezultateve të vrojtimit të aktivitetit kreditues për biznese dhe individë. Grafiku paraqet indeksin e balancës neto kumulative nga tremujori i katërt 2009.

Burimi: Banka e Shqipërisë

[9] *Gjatë vitit 2015, ecuria e portofolit të kredisë është ndikuar edhe nga fshirjet e kredive të këqija nga bilancet e bankave në përmbushje edhe të kërkesave të kuadrit rregullator që hyri në fuqi në fillim të vitit. Për më shumë shiko http://www.bankofalbania.org/web/Raporti_vjetor_i_Mbikqyrjes_Bankare_56_1.php. Duke marrë parasysh këto ndryshime, rritja vjetore e kredisë për sektorin privat shfaqet më e lartë, në 2.7%.*

Kreditimi në lekë ka shfaqur ritme vjetore rritjeje prej 7.5% në tremujorin e dytë. Ecuria pozitive e kredisë në lekë ka ndikuar në rritjen në 42.5% të peshës së këtij portofoli ndaj totalit, një peshë kjo 2.5 pikë përqindje më e lartë se në muajin maj të një viti më parë. Kreditimi në valutë u tkurr me 0.7% në terma vjetorë. Dobësia e kreditimit në valutë është diktuar si nga ndërgjegjësimi i agjentëve ekonomikë për rrezikun e kursit të këmbimit, ashtu dhe nga orientimi i kërkesës për kredi për investime në lekë. Kjo e fundit është favorizuar nga ngushtimi i dukshëm i diferencës së normave të interesit të kredisë në lekë, krahasuar me atë në euro.

Grafik 11. Kreditimi i bizneseve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia për biznese është rritur me 2.0% vit mbi vit në tremujorin e dytë të vitit. Përmirësimi i portofolit të kredisë për biznese është mbështetur si nga kreditimi për nevoja likuiditeti, ashtu edhe nga rritja e kredisë për investime. Kredia për likuiditet u rrit me 2.0%[10], përkundrejt normës 1.6% që shënonte në fund të tremujorit të parë. Ndërkohë, kredia për investime shënoi një rritje vjetore prej 2.0% përkundrejt normës 1.0% në tremujorin e parë. Analiza e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë tregon se rritja në portofolin e kredisë për biznese është mbështetur nga financimi i sektorit të industrisë dhe i atij të shërbimeve. Teprica e kredisë për këta sektorë është rritur përkatësisht me 6.6% dhe 1.9% vit mbi vit. Kreditimi i sektorit të ndërtimit është reduktuar më tej, duke shënuar në fund të muajit maj një rënie vjetore prej 5.0%.

Tremujori i dytë konfirmoi edhe njëherë tendencën pozitive të kredisë për individë, të vërejtur që në gjysmën e dytë të vitit 2014. Teprica e kredisë për individë është rritur me 3.3% vit mbi vit. Zhvillimet pozitive në kredinë për individë duket të jenë mbështetur nga lehtësimi prej disa vitesh i kushteve të kreditimit, si në aspekt të kostos së financimit, ashtu edhe kushteve të tjera të kredisë.[11] Kredia për konsum shënoi një rritje vjetore prej 7.3%, përkundrejt normës 5.9%

[10] *Analiza e kredisë së bizneseve dhe individëve sipas qëllimit të përdorimit bazohet në tregues të përllogaritur mbi të dhënat e detajuara të raportuara nga bankat*

[11] *Referuar rezultateve të marra nga vrojtimi i aktivitetit kreditues. http://www.bankofalbania.org/web/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues_5311_1.php*

të regjistruar në fund të muajit mars. Ofertat tërheqëse, me norma interesi dhe kushte të tjera lehtësuese, duket se kanë nxitur ecurinë e kredisë konsumatore. Po kështu, formalizimi në tregun e punës mendohet të ketë ndihmuar në rritjen e numrit të individëve që plotësojnë kriteret për të marrë kredi. Ndërkohë, rritja vjetore e portofolit të kredisë hipotekare ka ngecur në nivele të moderuara prej 2%, duke u kushtëzuar si nga kërkesa e dobët e individëve për të blerë banesa, ashtu edhe nga problemet e tregut.[12]

Grafik 12. Kreditimi i individëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë pret një ecuri lehtësisht më të mirë të kredisë në pjesën e mbetur të vitit. Përmirësimi i saj pritet të mbështetet nga kushtet e lehtësuara të kreditimit, nga normat e ulëta të interesit, si dhe nga një rol më aktiv i bankave në kreditim. Në veçanti, reduktimi i kërkesës së qeverisë për financim në tregun e brendshëm do të krijojë më shumë hapësira për rritjen e kreditimit të sektorit privat.

3.4. ECURIA E TREGUESVE MONETARË

Oferta e parasë rezultoi me rritje të qëndrueshme në muajt prill-maj. Agregati i parasë së gjerë, M3, shënoi një normë vjetore rritjeje prej 4.8% në muajin maj, kundrejt normës 4.1% të shënuar në fund të tremujorit të parë. Ecuria pozitive e agregatit M3 ka vijuar të mbështetet gjerësisht nga komponenti valutor (6.6 pikë përqindje). Financimi i qeverisë nga sektori bankar ka dhënë gjithashtu kontribut pozitiv në terma vjetorë (2 pikë përqindje). Kërkesa e sektorit privat për financim vijon të shfaqet e dobët, duke dhënë një kontribut të ulët në krijimin e parasë në ekonomi (1.3 pikë përqindje).[13]

[12] *Referuar rezultateve të marra nga vrojtimi i aktivitetit kreditues. http://www.bankofalbania.org/web/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues_5311_1.php*

[13] *Diferenca midis rritjes së agregatit M3 dhe kontributeve të listuara më sipër qëndron në kontributin negativ të zërit residual "Të tjera neto".*

Grafik 13. Zhvillimet në treguesit monetarë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Agregati M2 shënoi normë vjetore rritjeje prej rreth 5.4% në muajin maj, kundrejt 4.6% në muajin mars. Ecuria e agregatit M2 reflekton kryesisht zhvillimet pozitive të aktivitetit kreditues për sektorin privat në monedhën vendase. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj agregatit M2 ka shënuar rritje në 30.7% në muajin maj, duke reflektuar kërkesën e lartë për para likuide.

Grafik 14. Zhvillimet në depozita



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Stoku total i depozitave[14] në banka, në muajin maj, rezultoi rreth 4.2% më i lartë se një vit më parë. Në terma absolutë, ato u rritën me rreth 3.6 miliardë lekë nga muaji mars, duke shënuar përmirësim kundrejt tremujorit të parë të vitit. Normat e ulëta të interesit për depozitat kanë vijuar të ndikojnë në zhvendosjen kohore të depozitave drejt një strukture më likuide. Paralelisht me të, vihet re dhe

[14] *Analiza e depozitave përfshin dhe depozitat me afat maturimi mbi dy vjet, të cilat nuk përfshihen në llogaritjen e parasë së gjerë M3.*

një zhvendosje drejt depozitave me maturitet mbi dy vjet, të cilat karakterizohen nga norma interesi më të larta. Ecuria pozitive e depozitave në muajt prill-maj u mbështet nga ecuria e mirë e depozitave në monedhë vendase. Në terma vjetorë, stoku total i depozitave në lekë u zgjerua me 3.9%, ndërsa depozitat në valutë me 4.6% vit mbi vit. Depozitat e individëve kanë dhënë kontributin më të madh në zgjerimin e stokut të depozitave gjatë kësaj periudhe.

Oferta e parasë pritet të zgjerohet me ritme më të larta në pjesën e mbetur të vitit. Krijimi i parasë në ekonomi do të mbështetet kryesisht nga rritja e kredisë për sektorin privat dhe nga flukset valutore nga jashtë. Zgjerimi i depozitave do të marrë kryesisht formën e depozitave në lekë, ndërkohë që pritet një rritje e mëtejshme e depozitave me afat mbi dy vjet. Zhvillimet e pritura monetare janë në linjë me përmirësimin e aktivitetit ekonomik në vend dhe nuk pritet të ushtrojnë presione inflacioniste në horizontin kohor afatmesëm.

4. INFLACIONI DHE RRITJA EKONOMIKE

Aktiviteti ekonomik ka shënuar rritje në gjysmën e parë të vitit, por presionet inflacioniste kanë mbetur të ulëta. Inflacioni mesatar vjetor rezultoi 1.8% në tremujorin e dytë të vitit, duke qëndruar poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Presionet e ulëta inflacioniste vijojnë të përcaktohen nga rritja e ekonomisë nën potencial. Gjithashtu, ato janë ndikuar edhe nga niveli i ulët i inflacionit në tregjet partnere, si dhe nga pritjet e ulëta për inflacionin.

Ndikimi i këtyre faktorëve do të vazhdojë të jetë i pranishëm në horizontin afatshkurtër, por inflacioni pritet të kthehet në objektiv brenda një afati të mesëm kohor. Ky parashikim është i kushtëzuar nga parashikimet për një përmirësim progresiv të ritmit të rritjes ekonomike në të ardhmen.

Ekonomia shqiptare u rrit me 2.8% në tremujorin e parë, e mbështetur nga rritja e investimeve dhe nga përmirësimi i bilancit të shkëmbimeve tregtare me vendet e huaja. Nga ana tjetër, konsumi privat shënoi rënie, ndërsa konsumi i sektorit publik ishte pothuaj i pandryshuar. Tremujori i dytë vlerësohet të ketë shënuar ritme të ngjashme rritjeje me tremujorin paraardhës. Viti 2015 pritet të prodhojë një rritje më të lartë se ajo e vitit të shkuar, por aktiviteti ekonomik i gjashtëmujorit të dytë mund të ndikohet nga efektet e situatës në Greqi.

Në afat të mesëm, aktiviteti ekonomik i vendit pritet të qëndrojë në një trajektore rritëse, duke reflektuar kushtet e favorshme të financimit, reduktimin e primeve të rrezikut në vend dhe përmirësimin e aktivitetit ekonomik e financiar në Eurozonë.

4.1. AMBIENTI I JASHTËM I EKONOMISË

4.1.1. EKONOMIA BOTËRORE

Rritja ekonomike botërore u zbut në tremujorin e parë të këtij viti, kryesisht si pasojë e tkurrjes së aktivitetit ekonomik në disa nga ekonomitë në zhvillim. Dinamika e treguesve paraprakë dhe të tërthortë në tremujorin e dytë sugjeron se ekonomia botërore do të vijojë të rritet gradualisht dhe do të mbështetet në gjallërimin e ekonomive të zhvilluara.[15] Normat e papunësisë në këto shtete kanë ndalur rritjen dhe shumë prej tyre kanë treguar përmirësim të tregut të punës. Presionet inflacioniste vijojnë të jenë të ulëta, si pasojë e ndikimit të çmimeve të ulëta të lëndëve energjetike dhe atyre të para.

[15] *Paragrafi i referohet kryesisht buletinit ekonomik të BQE-së, qershor 2015 dhe analizës së treguesve PMI kryesorë paraprijës për PBB-në nga Markit, qershor dhe korrik 2015.*

Tabelë 1. Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë

	Ndryshimi i PBB-së		Norma e papunësisë	Norma e inflacionit	
Shtetet	T1-15/ T4-14	T1-15/ T1-14	Maj-15	Qer-15/ Maj-15	Qer-15/ Qer-14
ShBA	-0.2	2.7	5.3*	0.3	0.1
Eurozonë	0.4	1.0	11.1	0.0	0.2
Gjermani	0.3	1.0	4.7	-0.1	0.3
Francë	0.6	0.7	10.3	-0.1	0.3
Mbretëri e Bashkuar	0.3	2.4	5.6	0.0	0.0

Burimi: BQE, FED, Eurostat dhe institutet statistikore përkatëse.
** Muaji qershor.*

EKONOMIA E EUROZONËS

Të dhënat e fundit të publikuara nga Eurostat[16] tregojnë se ekonomia e Eurozonës u rrit me 1.0% në tremujorin e parë të vitit 2015, nga 0.9% në tremujorin e fundit të vitit të kaluar. Rritja ekonomike u mbështet nga rritja e konsumit dhe e investimeve, ndërkohë që kërkesa e jashtme frenoi rritjen e PBB-së. Të dhënat paraprake sugjerojnë për vijimin e kontributit pozitiv të konsumit të brendshëm në formimin e PBB-së edhe në tremujorin e dytë. Vlerësimet paraprake tregojnë se aktiviteti ekonomik po përshpejtohet dhe se rritja ekonomike në 2015-ën do të jetë më e lartë se në vitin e kaluar. Treguesit e besimit të biznesit dhe konsumatorëve janë shfaqur më të luhatur, duke faktorizuar ngërçin në zgjidhjen e krizës së Greqisë.

Grafik 15. Indeksi i përbërë i prodhimit dhe PBB-ja tremujore (majtas), ecuria e treguesve të vrojtimit për biznesin, konsumatorët dhe ndjesinë ekonomike (djathtas)



Burimi: Markit, Eurostat, KE.

Normat vjetore të inflacionit për periudhën prill-qershor janë luhatur në intervalin 0% - 0.3%, duke u larguar nga vlerat negative të tremujorit të parë. Parashikimet afatmesme të BQE-së rishikuan për lart inflacionin e pritur në 2015-ën (0.3% nga 0% i parashikuar në muajin mars).[17]

[16] *Second estimate for the 1-st quarter of 2015, 9 qershor 2015.*
[17] *ECB staff macroeconomic projections for the euro, BQE, 3 qershor 2015.*

EKONOMIA E SHBA-SË

Ekonomia e ShBA-së është ngadalësuar në tremujorin e parë të vitit, duke regjistruar një tkurrje prej 0.2%. Në terma vjetorë, rritja shënoi vlerën 2.7%. Aktiviteti ekonomik i ShBA-së u ndikua nga faktorë të përkohshëm (moti i keq), të cilët sollën një tkurrje të investimeve dhe të eksporteve. Treguesit e tërthortë në muajt e fundit, sugjerojnë për një rikthim në terren pozitiv të rritjes ekonomike në tremujorin e dytë, e ushqyer nga shpenzimet konsumatore dhe nga përmirësimi i vazhdueshëm i tregut të punës. Inflacioni ka vijuar të qëndrojë në nivele të ulëta (0% dhe 0.1% përkatësisht në muajt maj dhe qershor), duke reflektuar ecurinë rënëse të lëndëve të para, të naftës dhe të produkteve energjetike.

EKONOMITË E RAJONIT

Ekonomia e **Italisë** i është rikthyer ritmit pozitiv të rritjes në tremujorin e parë të 2015-ës. PBB-ja regjistroi një rritje tremujore prej 0.3% dhe vjetore prej 0.1%, duke e nxjerrë teknikisht Italinë nga recesioni. Në llogaritjen e vlerës së shtuar në ekonomi vërehet një kontribut pozitiv nga të gjithë sektorët dhe përbërësit e PBB-së. Treguesit paraprakë të tremujorit të dytë konfirmojnë dinamikën pozitive të ekonomisë. Sipas parashikimeve të ekspertëve, rritja ekonomike do të vijojë të forcohet gjatë vitit 2015. Normat e inflacionit janë rikthyer në terren pozitiv muajt e fundit, duke njohur rritje të lehta.

Sipas të dhënave paraprake, ekonomia e **Greqisë** është tkurrur në tremujorin e parë të këtij viti, krahasuar me një tremujor më parë. Në terma vjetorë, rritja ekonomike ka ruajtur vlera pozitive (0.2%). Tkurrja në terma tremujorë e aktivitetit (-0.2%) ka reflektuar kryesisht rënien e investimeve. Tremujori i dytë pritet të jetë influencuar negativisht nga pasiguria e agjentëve ekonomikë në lidhje me arritjen e marrëveshjes mes Greqisë dhe institucioneve krediduese. Në momentin e përgatitjes së raportit, është arritur një marrëveshje me trojkën (BE, BQE dhe FMN) për mbështetjen e Greqisë në këmbim të reformave strukturore të nevojshme. Perspektiva ekonomike e vendit mbetet e lidhur me zhvillimet politike dhe respektimin e zotimeve të marra nga qeveria greke.

Ekonomia **turke** ka ngadalësuar ritmin e rritjes në tremujorin e parë të vitit, duke shënuar 2.3% nga 2.6% një tremujor më parë. Vlen të theksohet zhvendosja e peshës në formimin e PBB-së nga eksportet drejt konsumit të brendshëm. Presionet inflacioniste mbetën të forta edhe në tremujorin e dytë, ndonëse norma e inflacionit u ul në 7.2% në muajin qershor, nga 7.6% në muajin mars. Të dhënat e treguesve të tërthortë dhe atyre të besimit janë në drejtime të ndryshme dhe nuk përcaktojnë prirje të qarta. Gjithsesi, të dhënat nga prodhimi industrial dhe i shitjeve sugjerojnë një vijim të rritjes ekonomike edhe në tremujorin e dytë.

Aktiviteti ekonomik në **Maqedoni** ka vazhduar të rritet me ritme të shpejta edhe në tremujorin e parë të vitit. Mbështetja ndaj rritjes së PBB-së ka ardhur

kryesisht nga konsumi i brendshëm dhe më pak nga eksportet neto dhe investimet. Të dhënat e tërthorta të prodhimit janë në ulje dhe sugjerojnë se ekonomia në Maqedoni mund të ngadalësojë rritjen në tremujorin e dytë të vitit. Pas tre muajve të parë të vitit në terren negativ, normat e inflacionit u rikthyen pozitive dhe po shfaqin rritje të lehta muajt e fundit.

Tabelë 2. Tregues ekonomikë për vendet e rajonit

Vendet	Ndryshimi i PBB-së		Inflacioni vjetor	Norma e papunësisë
	T1:15/T4:14	T1:15/T1:14	Qershor-15	Maj -15
Itali	0.3	0.1	-0.6	12.9
Greqi	-0.2	0.4	-2.8	25.5[I]
Maqedoni	-	3.2	0.5	27.3[I]
Serbi	-0.4	-1.8	1.9	19.2[I]
Kroaci	0.05	0.5	-0.9	17.0
Turqi	1.3	2.3	7.2	9.6[III]
Kosovë	-	3.3[II]	-0.4	35.3[IV]
Shqipëri	0.3	2.8	1.4	17.3[I]

I- Vlera për tremujorin e parë 2015;
II-Vlera për tremujorin e katërt 2014;
III-Vlera për muajin prill 2015;
IV-Vlera për vitin 2014.
Burimi: Institutet statistikore dhe bankat qendrore përkatëse.

Rritja ekonomike e tremujorit të fundit të 2014-ës në **Kosovë** shënoi 3.3%, nga 1.4% një tremujor më parë. Kontributin kryesor e dhanë rritja e konsumit dhe e eksporteve neto, ndërkohë që shpenzimet qeveritare u tkurrën ndjeshëm. Në nivel vjetor, ekonomia e Kosovës ka ngadalësuar në 0.9% ritmin e rritjes në vitin 2014, nga 3.4% një vit më parë. Faktorët kryesorë kanë qenë ulja e konsumit dhe zvogëlimi i investimeve. Për tremujorin e parë të 2015-ës, treguesit paraprakë janë të luhatshëm dhe nuk tregojnë një drejtim të qartë. Deficiti i llogarisë korrente u zgjerua në tremujorin e parë, si rezultat i tkurrjes së transfertave qeveritare dhe i zvogëlimit të fluksit të të ardhurave. Në të njëjtën kohë, rritja e remitancave dhe e IHD-ve ka zbutur zhvillimet e sipërpërmendura. Treguesit e tregut të punës paraqesin një papunësi në rritje, në 35.3% në vitin 2014 nga 30% një vit më parë. Pesha e lartë e çmimeve të mallrave të importuara në inflacionin vendas ka bërë që ecuria e çmimeve të jetë e njëjtë me ato të partnerëve kryesorë tregtarë (Eurozonë). Duke filluar nga muaji dhjetor i vitit të kaluar, normat e inflacionit janë në terren negativ. Muaji qershor regjistroi një inflacion prej -0.4%, nga -0.5% një muaj më parë.

ECURIA E ÇMIMEVE TË MALLRAVE KRYESORE NË TREGJET BOTËRORE

Rënia e çmimeve të mallrave kryesore ka vijuar edhe përgjatë tremujorit të dytë. Çmimet e energjisë dhe të metaleve përjetuan një tkurrje të qenësishme, nxitur nga tensionet në Greqi dhe në Kinë.

Çmimi i naftës në tregjet botërore humbi rreth 44.0% të vlerës së tij, në krahasim me një vit më parë. Mbështetur në indeksin evropian Brent, një fuçi nafte u tregtua mesatarisht me 62 dollarë/fuçi, nga 54$/fuçi që shënonte në tremujorin e kaluar. Kjo rritje me rreth 14% e çmimit është nxitur nga zgjerimi

i kërkesës më lart se pritjet dhe nga rënia e inventarëve në ShBA. Pavarësisht kësaj, pritjet për heqjen e sanksioneve ndaj Iranit dhe për një rritje të mundshme të ofertës në treg, ndikuan në rënien e çmimit në javën e fundit të muajit qershor.

Nën ndikimin e çmimit të naftës, edhe indeksi për çmimet e mallrave kryesore shënoi një rënie të theksuar prej 34% vit mbi vit. Ai u rrit me 4.0% në terma tremujorë. Çmimet e ushqimeve kanë ndjekur kahun rënës (-21.5% v-m-v), ndonëse me ritme më të moderuara në fund të periudhës së konsideruar. Kushtet klimaterike jo të favorshme kanë prekur ofertën për produktet bujqësore, duke diktuar një rritje të lehtë të çmimeve të ushqimeve në muajin qershor.

Grafik 16. Ndryshimet vjetore të çmimeve bazë



Burimi: FMN, EIA.

Në kushtet e një oferte të bollshme, çmimi mesatar i naftës për vitet 2015 dhe 2016 është rishikuar për poshtë, përkatësisht në 60 dhe 67$ për fuçi. Ndërkohë, çmimet mesatare të ushqimeve do të vijojnë të mbeten të moderuara.

4.1.2. TREGJET FINANCIARE BOTËRORE

Bankat qendrore kryesore i kanë lënë të pandryshuara normat e tyre bazë të interesit, përkatësisht në 0.05% BQE, në 0.15% Rezerva Federale, në 0.5% Banka e Anglisë dhe në 0-0.1% Banka e Japonisë.

Grafik 17. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore



Burimi: Bankat qendrore (BQE, Fed, BoJ dhe BoE).

Në tregjet e parasë të Eurozonës, normat euribor janë ulur më tej, duke reflektuar lehtësimin sasior të BQE-së. Duke filluar nga muaji maj, euribori 3-mujor gjendet në terren negativ. Normat libor për dollarin amerikan kanë ruajtur të njëjtin nivel me tremujorin e kaluar. Në tregjet e kapitaleve, *yield*-et e obligacioneve janë ndikuar nga zhvillimet në Greqi dhe kanë shfaqur ecuri rritëse për të gjitha kategoritë e vlerësimit. Ngërçi i arritjes së marrëveshjes me Greqinë ka shqetësuar agjentët financiarë, duke ndikuar në rritjen e *yield*-eve për shumë instrumente borxhi në treg. Gjithsesi, politika e lehtësimit sasior nga ana e BQE-së ka dhënë efektet e saj. Duke përjashtuar Greqinë, niveli i *yield*-eve gjendet në vlera më të ulëta sesa në periudhën para fillimit të kësaj politike.

Grafik 18. Ecuria e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare



Burimi: Bloomberg, Reuters dhe Eurostat.

Në tremujorin e dytë, euroja është nënçmuar ndaj dollarit amerikan dhe ndaj shumë monedhave kryesore. Ajo ka fituar terren ndaj dollarit amerikan në muajin e fundit dhe po rikuperon nënçmimin e ndodhur për shkak të fillimit të politikës së BQE-së. Në terma mesatarë bilateralë, në muajin qershor, një euro u këmbye me 1.1213 dollarë amerikanë, duke u mbiçmuar 0.6% krahasuar me një muaj më parë. Në terma tremujorë, euroja u nënçmua 1.8% ndaj monedhës së gjelbër.

4.2. PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO DHE ECURIA E KËRKESËS AGREGATE

Rritja ekonomike rezultoi 2.8% në tremujorin e parë të vitit 2015, duke qëndruar më lart se pritjet tona. Investimet private e publike dhe eksportet e huaja neto kontribuuan në rritjen e ekonomisë, ndërkohë që konsumi i familjeve shqiptare shënoi rënie.

Në balancë, informacioni i disponuar për tremujorin e dytë të vitit, tregon për vijimësinë e normave pozitive të rritjes. Rritja ekonomike në gjashtëmujorin e dytë të vitit pritet të ndikohet negativisht nga një rënie e mundshme e eksporteve dhe e remitancave nga Greqia. Për vitin në tërësi, rritja ekonomike parashikohet të jetë më e lartë se ajo e vitit të kaluar.

Rritja ekonomike për tremujorin e parë të vitit rezultoi e përmirësuar; prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 2.8% dhe 0.3% në nivel vjetor e tremujor. Në linjë me vlerësimet tona, konsumi privat shënoi rënie, duke reflektuar zhvendosjen e një pjese të burimeve financiare për pagimin e faturave të prapambetura të energjisë elektrike. Nga ana tjetër, investimet në ekonomi dhe eksporti i mallrave e shërbimeve shqiptare shënoi rritje.

Nga këndvështrimi sektorial, kontributi i ulët i sektorit bujqësor dhe rënia e

prodhimit e përpunimit të naftës, u kompensuan nga rritja e lartë e prodhimit të energjisë elektrike. Nga ana tjetër, kontributi i sektorit të shërbimeve në rritjen e vlerës së shtuar të ekonomisë u përgjysmua në krahasim me fundin e vitit të kaluar.

Në balancë, informacioni i disponuar për tremujorin e dytë të vitit 2015, tregon për vijimësinë e normave pozitive të rritjes.[18] Kërkesa e brendshme pritet të jetë komponenti kryesor i rritjes, e mbështetur nga normat e ulëta të interesit në ekonomi, nga përmirësimi i besimit në ekonomi, si dhe nga notat më të zbutura të konsolidimit fiskal. Ngadalësimi i eksporteve dhe i remitancave nga Greqia vlerësohet të reduktojë me rreth 0.25 pikë përqindjeje rritjen ekonomike për vitin. Megjithatë, në vlerësimin tonë, ekonomia do të regjistrojë një normë më të lartë rritjeje sesa ajo e vitit të kaluar.

Ky parashikim do të varet nga përmbushja e disa parakushteve, si: përmirësimi i kushteve të financimit dhe rikuperimi i dëshirës për të ndërmarrë rrezik në tregjet financiare; përballimi me efekte minimale i goditjeve që mund të vijnë nga kriza greke; përmirësime të mëtejshme të tregut të punës, të klimës së biznesit dhe të gatishmërisë për investime nga investitorë të brendshëm e të huaj.

Grafik 19. Ecuria vjetore dhe tremujore e PBB-së



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

[18] *Analiza ekonomike dhe vlerësimet e kërkesës agregate për tremujorin e dytë janë mbështetur mbi treguesit e përditësuar fiskalë, të tregtisë së jashtme, të kredisë dhe të depozitave deri në muajin maj dhe të treguesve të besimit për tremujorin e dytë të vitit 2015.*

Hapësirë informuese 2. Prodhimi i brendshëm bruto tremujor, komponentët e kërkesës agregate dhe rëndësia për politikën monetare[I]

INSTAT publikoi për herë të parë, më 9 korrik 2015, serinë tremujore të prodhimit të brendshëm bruto (nga viti 2008 në terma nominalë dhe nga viti 2009 në terma realë). Vlerësimi i llogarive kombëtare tremujore u bë sipas metodës së prodhimit dhe të shpenzimeve, në harmonizim të plotë me metodologjinë[II] *e llogarive vjetore.*

Vlerësimet aktuale dhe të pritura të ecurisë ekonomike në këtë raport të politikës monetare e në ato të ardhshme, do të mbështeten në të dhënat tremujore të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) dhe komponentëve të tij. Për politikën monetare nuk është e mjaftueshme të analizohet vetëm ecuria e PBB-së, por kërkohet të trajtohen edhe faktorët që e ndikojnë ecurinë e saj. Në varësi të përqasjes së ndjekur në llogaritjen e PBB-së mund të ndërtohen profile të ndryshme analizash makroekonomike, si nga pikëpamja e prodhimit, ashtu edhe ajo e shpenzimeve. Në këtë hapësirë informuese pasqyrohen në mënyrë sintetike profili i PBB-së sipas aktiviteteve ekonomike dhe sipas komponentëve të shpenzimeve, duke nënvizuar rëndësinë e këtyre të fundit për analizën ekonomike dhe procesin e parashikimit, në funksion të vendimmarrjes efektive të politikës monetare.

Grafik 20. Prodhimi i brendshëm bruto sipas sektorëve në ekonomi.



*Shënim: Indekset nëpër tremujorë pasqyrojnë shumën rrëshqitëse vjetore të vlerës së shtuar sipas aktiviteteve ekonomike, të taksave minus subvencioneve mbi produktet dhe PBB-së, me frekuencë tremujore dhe në terma realë

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Në analizën e PBB-së sipas metodës së prodhimit, vlera e shtuar nga sektori i shërbimeve dëshmon për një tendencë rritëse të aktiviteteve të shërbimeve. Shërbimet përfaqësojnë edhe sektorin me peshën më të lartë në PBB, rreth 45.4% të PBB-së nominale të vitit 2014. Ndërkohë, sektori i industrisë dhe i ndërtimit kanë shfaqur luhatshmëri më të lartë, krahasuar me sektorët e tjerë. Prirja rritëse e sektorit të industrisë është reflektuar në rritjen e peshës së tij në PBB, nga 9% në vitin 2008 në 12% në vitin 2014, ndërsa dinamika rënëse e sektorit të ndërtimit ka tkurrur peshën e saj në PBB nga 16% në vitin 2008 në 10% në vitin 2014.

PBB-ja, sipas metodës së shpenzimeve, mbledh konsumin final të mallrave dhe të shërbimeve (nga familjarët, nga administrata publike dhe nga institucionet jofitimprurëse), formimin bruto të kapitalit fiks, eksportin neto dhe ndryshimin e gjendjeve[III]*. Konsumi final i familjarëve është komponenti kryesor. Pesha e tij mesatare në kërkesën agregate gjatë pesë viteve të fundit është 80%. Formimi bruto i kapitalit fiks ka një peshë më të vogël, përkatësisht 28%, por ka luhatje më të theksuara dhe ka përcaktuar luhatjet e kërkesës agregate. Konsumi i administratës publike ka një peshë 11% dhe eksportet neto -20% për periudhën 2010-2015*[IV]*.*

Konsumi final i popullatës është rritur mesatarisht 1.6% në terma realë për periudhën 2010-2015, 0.6 pikë përqindje më pak se norma rritëse e PBB-së për këtë periudhë.

Ritmet rritëse të këtij komponenti u zvogëluan ndjeshëm gjatë vitit 2012, një vit pas krizës financiare të Eurozonës, si rrjedhojë e rritjes së nivelit të pasigurisë[V]. Ritmet rritëse të konsumit privat u rikuperuan gjatë dy viteve në vijim, duke përbërë kontribuesin kryesor në rritjen e kërkesës agregate, së bashku me konsumin final të administratës publike. Komponenti i formimit bruto të kapitalit fiks shfaqi një ecuri më të ngadaltë pas krizës. Pasi dha kontribut mesatar negativ tre vjet rradhazi (2012-2014), ai u kthye në kontribuesin kryesor të rritjes së kërkesës agregate në tremujorin e parë të vitit 2015. Eksportet neto kanë shfaqur luhatje më të larta për periudhën në analizë. Të ndikuara drejtpërdrejt nga rënia e kërkesës globale, eksportet neto ishin i vetmi komponent i kërkesës agregate që ndikoi negativisht gjatë vitit 2011. Ndërkohë, një vit më pas, eksportet neto ishin mbështetësi kryesor i rritjes së kërkesës agregate, për të dhënë sërish kontributin më të lartë në tremujorin e parë të vitit 2015.

Grafik 21. Prodhimi i brendshëm bruto sipas shpenzimeve.



*Shënim: Indekset nëpër tremujorë pasqyrojnë shumën rrëshqitëse vjetore të komponentëve të kërkesës agregate, me frekuencë tremujore dhe në terma realë.

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë

Politika monetare ka efekt të kuptueshëm e të monitorueshëm mbi komponentët e kërkesës agregate, por ajo nuk mund të ndikojë në mënyrë selektive sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Për këtë arsye, analiza dhe parashikimi i përbërëseve të shpenzimeve ka rëndësi primare për politikën monetare. Për shembull, zbatimi i një politike monetare lehtësuese nxit familjarët të kursejnë më pak dhe të shpenzojnë më shumë, investimet e bizneseve bëhen më pak të kushtueshme (rritje e investimeve apo formimit bruto të kapitalit fiks) dhe kursi i këmbimit nënçmohet, duke i bërë më të shtrenjta importet dhe më pak të kushtueshme eksportet dhe (përmirësim i bilancit tregtar). Publikimi i PBB-së me metodën e shpenzimeve bën të mundur vlerësimin e efektit që politika monetare ka në secilin komponent, madhësinë dhe kohëzgjatjen e transmetimit të efektit. Pasurimi i bazës së të dhënave me këtë informacion mundëson një planifikim dhe monitorim më të mirë të politikës monetare.

I *Përgatitur nga I. Metani dhe E. Kristo, Departamenti i Politikës Monetare.*

II *Metodologjitë bazë në llogaritjen e PBB-së janë Sistemi Evropian i Llogarive (ESA 2010) dhe Sistemi i Llogarive Kombëtare (SNA 2008).*

III *Ndërmarrjet përfshihen në procesin e formimit bruto të kapitalit fiks dhe ndryshimin e gjendjeve, por nuk janë të përfshira në komponentin e konsumit final të mallrave dhe të shërbimeve. Familjarët, administrata publike dhe institucionet jofitimprurëse janë të përfshirë në komponentin e konsumit final në ekonomi, në formimin bruto të kapitalit fiks dhe ndryshimin e gjendjeve.*

IV *Ndryshimet e gjendjeve nuk llogariten në frekuencë tremujore dhe sipas llogarive kombëtare vjetore kanë një peshë 2% në PBB për periudhën 2008 – 2013. Konsumi i ndërmarrjeve jofitimprurëse zë një peshë të papërfillshme në formimin e kërkesës agregate, 0.2% mesatarisht gjatë pesë viteve të fundit.*

V *Vlerësohet se kriza financiare e Eurozonës pati efekt në ekonominë e vendit tonë dhe u përçua fillimisht, nëpërmjet kanalit të tregtisë gjatë vitit 2011 dhe nëpërmjet kanalit të pasigurisë gjatë vitit 2012. Treguesi i pasigurisë për konsumatorët, i vlerësuar nga të dhënat e vrojtimit të besimit të konsumatorit u rrit ndjeshëm gjatë vitit 2012, mbi mesataren e tij afatgjatë.*

4.2.1. PRODHIMI SIPAS SEKTORËVE[19]

Prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 2.8% në tremujorin e parë të vitit, duke u mbështetur si nga zgjerimi i sektorit prodhues, ashtu edhe nga rritja e sektorit të shërbimeve. Sektori prodhues kontribuoi me 1.6 pikë përqindje dhe sektori i shërbimeve me 1.1 pikë përqindje në rritjen vjetore të PBB-së[20]. **Sektori prodhues** pasqyroi kryesisht performancën e mirë të aktivitetit industrial. Kontribute pozitive në rritjen e PBB-së dhanë edhe aktivitetet e tjera prodhuese si "Bujqësia, pyje dhe peshkimi", 0.4 pikë përqindje, dhe "Ndërtimi", 0.2 pikë përqindje. Ndërkohë, dinamika e rritjes vjetore të **sektorit të shërbimeve** rezultoi më e ngadalësuar. Kontribut më të lartë në rritjen ekonomike gjeneruan "Administrata publike, arsimi dhe shëndetësia", 0.39 pikë përqindje dhe "Aktivitetet financiare dhe të sigurimit", 0.35 pikë përqindje.

Grafik 22. Prodhimi i brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe treguesit e besimit



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Vlera e shtuar në **sektorin e industrisë** u rrit me 7.6% në terma vjetorë, pas rritjes së ulët vjetore prej 0.8% në tremujorin e katërt të vitit të kaluar. Sipas të dhënave të indeksit të prodhimit, dega "Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar" shënoi zgjerimin më të lartë të prodhimit midis

[19] *Në datën 9 korrik të vitit 2015, INSTAT publikoi të dhënat e prodhimit të brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe komponentët e kërkesës agregate deri në tremujorin e parë të vitit 2015. Publikimi i të dhënave të reja, për të cilat është përmirësuar metodologjia dhe është pasuruar informacioni, përfshiu edhe rishikim të serive të mëparshme të lidhura edhe me përditësimin e informacionit. Të dhënat e vitit 2013 janë gjysmë përfundimtare, ato për vitin 2014 paraprake dhe të dhënat për vitin 2015 një publikim i parë, duke qenë subjekt rishikimi në të ardhmen. Më tepër detaje paraqiten në hapësirën informuese numër 2 "Prodhimi i brendshëm bruto tremujor, komponentët e kërkesës agregate dhe rëndësia për politikën monetare".*

[20] *Ndërkohë, komponenti i taksave minus subvencionet për produktet llogaritet të ketë kontribuar me 0.1 pikë përqindje në rritjen ekonomike.*

industrive me përkatësisht 37.4%[21]. Dega e industrisë përpunuese[22] kontribuoi në një masë të ulët, me 1.2 pikë përqindje. Në të kundërt, prodhimi i industrisë nxjerrëse regjistroi tkurrje të fortë vjetore, me 26.9%, duke e ndikuar në kahun negativ ecurinë e industrisë në total. Tendenca rritëse e treguesve të besimit në industri mbështet vlerësimin për dinamikë pozitive të sektorit në tremujorin e dytë.

Grafik 23. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në industri dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Sektori i ndërtimit ngadalësoi ritmet e rritjes vjetore në tremujorin e parë të vitit. Vlera e shtuar nga aktiviteti ndërtues u rrit me 2.8%, pas zgjerimit me 4.8% dhe me 8.7% në tremujorët e tretë dhe të katërt të vitit 2014. Dinamika pozitive në sektorin e ndërtimit shpjegohet kryesisht me realizimin e ndërtimeve të linjave të ujësjellësit, atyre elektrike dhe të telekomunikacionit[23] dhe të ndërtimeve në sektorin e industrisë[24]. Gjithashtu, situata më e përmirësuar e likuiditetit dhe vazhdimi i projekteve të investimeve publike vlerësohen të kenë dhënë ndikim pozitiv në sektorin e ndërtimit[25]. Rritja e kapaciteteve shfrytëzuese dhe vijueshmëria e investimeve publike në infrastrukturë sinjalizojnë për ecuri të përmirësuar në këtë sektor në tremujorin e dytë.

[21] *Nën ndikimin e kushteve të favorshme të motit (reshje të dendura të shiut në tremujorin e parë), ashtu edhe si rezultat i reformimit strukturor të sektorit të energjetikës.*

[22] *Të dhënat e indeksit të prodhimit tregojnë për tkurrje të prodhimit në disa nga nëndegët e industrisë përpunuese. Rënia e prodhimit në industritë tekstile dhe të veshjeve, të lëkurës dhe këpucëve, që zënë peshën më të lartë (30.1% për vitet 2012 – 2014) në industrinë përpunuese, sugjeron se kjo industri ka pasur ndikimin negativ më të madh në ecurinë e industrisë përpunuese. Duke qenë industri të orientuara kryesisht drejt eksporteve, kjo mbështetet edhe nga rritja e ulët vjetore e disa zërave të eksporteve të produkteve tekstile dhe të veshjeve, të lëkurës dhe këpucëve në tremujorin e parë.*

[23] *Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit regjistroi rritje vjetore më të lartë për këtë kategori të punimeve inxhinierike.*

[24] *Lejet e ndërtimit u miratuan kryesisht për ndërtesa industriale. Megjithatë, numri total i tyre ishte i ulët krahasuar me lejet e akorduara gjatë periudhës 2012 – 2014. Të dhënat e lejeve të ndërtimit dhe të llojeve të ndërtimeve publikohen në buletinet statistikore tremujore të INSTAT-it.*

[25] *Shlyerja e detyrimeve të prapambetura të qeverisë në fushën e infrastrukturës ndaj bizneseve të angazhuara në realizimin e punimeve inxhinierike publike (ndërtime dhe riparime rrugësh, shkollash etj.) vazhdoi të jetë e lartë edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2015. Gjithashtu, rritja e shpenzimeve kapitale të qeverisë në këtë tremujor dhe vijimi i realizimit të projekteve infrastrukturore të mbështetura nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve sugjeron për vazhdim të investimeve publike.*

Grafik 24. Ecuria e vlerës së shtuar dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në ndërtim



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

*Hapësirë informuese 3. Ecuria e çmimeve në tregun e banesave**

*Indeksi i çmimit të banesave u rrit 2.3% në tremujorin e dytë në krahasim me një vit më parë, ndërsa indeksi i qirasë ra me 0.4%, në terma realë. Pavarësisht luhatjeve afatshkurtra, indekset e çmimeve dhe të qirasë në tregun e banesave qëndrojnë nën mesataren e pesë viteve të fundit. Raporti i çmimit ndaj qirasë u rrit me 0.3 pikë, në krahasim me tremujorin e parë dhe reflektoi rritjen e çmimit të banesave në tremujorin e dytë.** Prirja e këtij treguesi gjatë pesë viteve të fundit ka qenë lehtësisht rënëse, e ndikuar nga rënia më e theksuar e çmimeve në krahasim me qiranë e banesave.*

Grafik 25. Indeksi i çmimit të banesave dhe raporti i tij ndaj indeksit të qirasë së banesave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Dinamika tremujore e indeksit të çmimeve në tremujorin e dytë ka reflektuar rritjen e besimit konsumator dhe lehtësimin e standardeve për kredinë hipotekare. Gjithashtu, bazuar në vrojtimin e aktivitetit kreditues, bankat raportuan se kërkesa e individëve për kredinë për blerje banesash është rritur në tremujorin e dytë. Nga ana e ofertës, rritja e lejeve të ndërtimit gjatë vitit të kaluar sinjalizon për shtim të investimeve në banesa të reja.

Grafik 26. Raporti çmim/qira dhe tregues nga vrojtimi i aktivitetit kreditues



Burimi: Banka e Shqipërisë.

* *Analiza e çmimit dhe e qirasë së banesave bazohet vetëm në informacionin mbi çmimet dhe qiratë në qytetin e Tiranës.*

** *Raporti i indeksit të çmimeve ndaj atij të qirasë është një tregues që përdoret si sinjalizues paraprak i mbinxehjes së tregut të çmimeve të banesave.*

Ecuria e vlerës së shtuar në ekonomi nga **sektori i bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit** rezultoi pozitive. Ky tregues regjistroi rritje vjetore me 1.9%, pas tkurrjes së vlerësuar me 2.5% në tremujorin e fundit të vitit 2014. Megjithatë, ritmi i rritjes së bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit, u luhat nën normën mesatare 4.2%, i ndikuar ndër të tjera nga përmbytjet në prodhimin bujqësor dhe blegtoral të zonave të jugut në tremujorin e parë. Në tremujorin e dytë[26] dhe në

Grafik 27. Kontributet e degëve dhe normat e shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorin e shërbimeve



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

[26] *Të dhënat e pjesshme për tremujorin dëshmojnë për rritje të lartë të eksporteve të disa kategorive të produkteve bazë bujqësore (si perimet e bimët medicinale) gjatë muajve prill dhe maj.*

vijim gjatë vitit, sektori vlerësohet të kontribuojë pozitivisht në rritjen ekonomike si rezultat i përmirësimit të infrastrukturës bujqësore, i një mbështetjeje më të mirë financiare nga sistemi bankar dhe i politikave lehtësuese të qeverisë[27].

Aktiviteti në **sektorin e shërbimeve** vijoi të ngadalësohet për të dytin tremujor radhazi. Në tremujorin e parë, degët e shërbimeve gjeneruan një vlerë të shtuar 2.5% më të lartë në terma vjetorë. Ecuria e sektorit pasqyroi kryesisht ngadalësimin e rritjes në degën e tregtisë, hoteleve e restoranteve dhe transportit[28], në 1.2%. Tendenca ngadalësuese shfaqën edhe degët e tjera, me përjashtim të aktiviteteve financiare dhe të sigurimit. Vlera e shtuar në këtë degë u rrit ndjeshëm dhe kontribuoi me 0.8 pikë përqindje në sektorin e shërbimeve. Perspektiva e sektorit në tremujorin e dytë vlerësohet të mbetet në kahun rritës. Rritja e treguesit të besimit të shërbimeve dhe vlerësimi për shfrytëzim më të lartë të kapaciteteve prodhuese sugjerojnë për përmirësim të aktivitetit.

4.2.2. KËRKESA AGREGATE

Rritja e kërkesës agregate në tremujorin e parë u mbështet kryesisht nga rritja e investimeve dhe nga përmirësimi i bilancit tregtar të shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve me jorezidentët. Nga ana tjetër, shpenzimet e familjeve shqiptare rezultuan në rënie. Kërkesa e brendshme u zgjerua me ritme më të ngadalta, ndërsa kontributi pozitiv i eksporteve neto ishte në rritje, në krahasim me tremujorin e katërt të vitit 2014.

Të dhënat paraprake sugjerojnë për vijimin e normave të rritjes në tremujorin e dytë. Struktura e rritjes vlerësohet të jetë e balancuar, e ndikuar pozitivisht nga rritja e kërkesës së brendshme dhe nga ngushtimi i deficitit të eksporteve neto.

Kërkesa agregate shënoi rritje në tremujorin e parë, e mbështetur si nga kontributi i kërkesës së brendshme (1.9 pikë përqindje), ashtu edhe nga ai i eksporteve reale neto (2.8 pikë përqindjeje).[29] Në krahasim me fundin e vitit të kaluar, kërkesa e brendshme e uli me 0.6 pikë përqindje kontributin në PBB. Ky ngadalësim u shkaktua më së shumti nga rënia e konsumit të mallrave dhe të shërbimeve nga konsumatorët. Në kontrast me të, rritja dyshifrore e formimit bruto të kapitalit fiks mbështeti rritjen e kërkesës së brendshme dhe ishte kontribuesi kryesor i saj. Duke gjykuar nga treguesit e vrojtimeve, grumbullimi i inventarëve në tremujorin e parë dha një kontribut pozitiv në rritjen e kërkesës agregate të tremujorit të parë.[30]

---

[27] *Në kuadrin e vijimit të zbatimit të masave të paketës së qeverisë për sektorin bujqësor dhe atë agropërpunues, të cilat synojnë të nxisin zhvillimin e mëtejshëm të sektorit.*

[28] *Kjo degë zë peshën më të madhe në sektorin e shërbimeve, rreth 37% e vlerës së shtuar të shërbimeve të shprehur me çmime korrente për periudhën 2009–2014. Të dhënat e shifrës së afarizmit në vëllim tregojnë për ngadalësim më të ndjeshëm të aktivitetit tregtar me shumicë.*

[29] *Kontributi i zërit "ndryshimi i gjendjeve dhe mospërputhje statistikore", i cili llogaritet si mbetje e dy vlerave të PBB-së së llogaritur sipas dy metodave, të prodhimit dhe të shpenzimeve, është -1.9 pikë përqindje në tremujorin e parë.*

[30] *Bazuar në metodologjinë e INSTAT-it, ndryshimi i gjendjes së inventarëve nuk vlerësohet gjatë llogaritjeve për PBB-në tremujore, por ky zë i shtohet komponentit të mospërputhjeve statistikore.*

Të dhënat e vrojtimeve të besimit tregojnë për vijimin e pririjes rritëse të ekonomisë në tremujorin e dytë. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) qëndron mbi mesataren e tij historike.

Grafik 28. Struktura e kërkesës agregate (kontribute në ndryshimin vjetor të PBB-së) dhe treguesi i ndjesisë ekonomike, TNE (mesatare afatgjatë=100)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

4.2.3. KONSUMI DHE INVESTIMET PRIVATE

Konsumi privat regjistroi rënie vjetore me 1.2% në tremujorin e parë, duke reflektuar zhvendosjen e burimeve financiare drejt pagimit të faturave të prapambetura të energjisë elektrike, por edhe pririjen e konsumatorëve për të kursyer.[31] Burimet e financimit të konsumit privat u mbështetën nga rritja e remitancave dhe e kredisë konsumatore.

Ndarja më e detajuar e treguesve afatshkurtër dhe e vlerës së shtuar sipas sektorëve mundëson vlerësimin e konsumit familjar sipas grupeve kryesore të klasifikimit.[32] Rënia e konsumit u reflektua në masën më të madhe në tkurrjen e shpenzimeve konsumatore për mallrat e qëndrueshëm. Nga ana tjetër, shpenzimet për mallra për përdorim afatshkurtër dhe për shërbime janë rritur.

[31] *Bazuar në rezultatet e rubrikës së veçantë të vrojtimit të besimit konsumator për tremujorin e dytë të vitit, arsyet kryesore të kursimit ishin pasiguria për të ardhmen dhe zhvendosja e konsumit në një kohë më të vonë. Më konkretisht, 46% e konsumatorëve të pyetur kursejnë për të pasur fonde në dispozicion për të papritura dhe 39% për të konsumuar në të ardhmen.*

[32] *Konsumi privat klasifikohet në 4 kategori sipas jetëgjatësisë dhe qëllimit të përdorimit: (i) mallra të qëndrueshme, të cilat përfshijnë mallra që mund të përdoren mbi 3 vjet (si për shembull mobilie, elektroshtëpiake, vetura etj), (ii) mallra gjysmë të qëndrueshme të cilat mund të përdoren nga 1 deri në 3 vjet (veshje, këpucë etj), (iii) mallra jo të qëndrueshme të cilat kanë një kohë të shkurtër përdorimi, zakonisht më pak se 1 vit (ushqime, karburant, energji etj.) dhe (iv) shërbimet.*

Grafik 29. Ecuria e konsumit privat dhe besimit në sektorin e tregtisë



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Treguesit afatshkurtër të konsumit privat sugjerojnë kontribut të ulët por pozitiv në rritjen e kërkesës agregate në tremujorin e dytë. Përmirësimi i besimit të konsumatorëve dhe i besimit në sektorin e shërbimeve sugjeron rritje të shpenzimeve konsumatore në tremujorin e dytë.

Investimet u rritën 14.1% në tremujorin e parë, në vijim të rritjes me 7.3% dhe 7.8% të dy tremujorëve paraardhës. Ky komponent dha kontributin kryesor në rritjen e kërkesës agregate në tremujorin e parë me 3 pikë përqindje. Zhvillimet pozitive u mbështetën nga rritja e investimeve të huaja direkte, nga rritja e sektorit të ndërtimit, nga rritja e investimeve publike dhe nga lehtësimi i standardeve të kredisë së

Grafik 30. Tregues të tërthortë për ecurinë e konsumit privat në tremujorin e dytë

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Grafik 31. Ecuria e formimit bruto të kapitalit fiks, ndryshime vjetore



Burimi: INSTAT.

dhënë për investime. Lejet e ndërtimit për ndërtesat jorezidenciale dhe ndërtimet inxhinierike, të cilat korrelojnë me ecurinë e investimeve nga sektori i ndërtimit, janë rritur në tremujorin e parë. Rritja me 22.5% e importit të makinerive dhe pajisjeve në këtë periudhë ka dhënë kontribut pozitiv në formimin bruto të kapitalit fiks. Gjithashtu, investimet e huaja direkte hyrëse u rritën me 48.7% në këtë periudhë.

Investimet priten të japin kontribut të lartë në rritjen e kërkesës agregate edhe në tremujorin e dytë, të mbështetura nga përmirësimi i besimit të biznesit dhe nga rritja e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese.

Rritja me 11% e importit të makinerive dhe pajisjeve për periudhën prill-maj sugjeron kontribut pozitiv të këtij komponenti në formimin bruto të kapitalit.

Grafik 32. Tregues afatshkurtër të investimeve private për tremujorin e dytë



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

4.2.4. KËRKESA E SEKTORIT PUBLIK DHE POLITIKA FISKALE

Stimuli fiskal, i matur nëpërmjet ndryshimit vjetor të deficitit primar, ka rezultuar lehtësisht pozitiv në pesë muajt e parë të vitit. Ndonëse pozitiv, bilanci primar ka qenë rreth 0.7 miliardë lekë më i ulët se një vit më parë. Nga ana tjetër, deficiti i përgjithshëm buxhetor ka ardhur në rënie, si pasojë e reduktimit të shpenzimeve për interesa. Të dhënat deri në muajin maj dëshmojnë një rritje të të ardhurave, rritje e cila ka tejkaluar zgjerimin e shpenzimeve buxhetore. Këta tregues janë pasqyruar në një ngushtim të deficitit në terma vjetorë.

Grafik 33. Orientimi i politikës fiskale, i përafruar nga ndryshimi i deficitit primar*



Δ Deficiti primar pa përfshirë detyrimet e prapambetura, shuma rrëshqitëse (DP/PBBt-DP/PBBt-1)

*Stimuli fiskal është përafruar nga ndryshimet e raporteve të shumës rrëshqitëse 12 -mujorë të deficitit primar mujor ndaj PBB-së, krahasuar me një vit më parë. Ndryshimet pozitive në këto raporte tregojnë stimul pozitiv fiskal, ndërkohë që diferencat negative sinjalizojnë konsolidim fiskal.

Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Shpenzimet buxhetore për pesë muajt e parë të vitit arritën në 161.7 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 3.3%. Pjesa kryesore e kësaj rritjeje ka ardhur si pasojë e rritjes së fortë të shpenzimeve kapitale, të cilat janë rritur me rreth 26.3% në terma vjetorë[33]. Shpenzimet korrente për këtë periudhë kanë arritur në rreth 132 miliardë lekë, me një rritje të lehtë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura për pesë muajt e parë të vitit ka arritur në 12.1

[33] *Shpenzimet kapitale u rritën me 26.3% në terma vjetorë, por kjo pjesë e vitit reflekton efekt -in statistikor të bazës së ulët krahasuese. Rritja e shpenzimeve kapitale ka kontribuar në rreth 71% të rritjes së shpenzimeve totale. Pjesa tjetër është ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet shpenzimeve korrente dhe shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.*

miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 6.5%.[34] Duke qenë se shpërndarja e detyrimeve të prapambetura në vitin e kaluar ka qenë e përqendruar pas tremujorit të parë të vitit, efekti i shlyerjes së këtyre detyrimeve në rritjen e shpenzimeve në periudhën pasardhëse pritet të jetë negativ.

Grafik 34. Ndryshimi vjetor i totalit të shpenzimeve sipas kontributeve të zërave kryesorë (majtas), pesha e përbërësve kryesorë të shpenzimeve tek shpenzimet totale (djathtas)



Burimi: Ministria e Financave.

Të ardhurat buxhetore arritën në 151.9 miliardë lekë në pesë muajt e parë të vitit, me një rritje vjetore prej 5%. Ndarja e këtij kontributi midis të ardhurave me karakter tatimor dhe atyre jotatimore është thuajse e barabartë. Ndër të ardhurat tatimore, zërat me kontributin më të madh në rritje janë të ardhurat nga "Tatimi mbi fitimin"[35], "Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore"[36] dhe të ardhurat nga "Akcizat" [37], të cilat në terma vjetorë, janë rritur përkatësisht me 24.3%, 13.3% dhe 11.2%. Kjo ecuri është balancuar nga tkurrja vjetore e të ardhurave nga "Tatimi mbi vlerën e shtuar", të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të të ardhurave nga tatimet dhe doganat. "Të ardhurat jotatimore"[38] janë rritur me rreth 39.3% në terma vjetorë, me një kontribut prej 2.4 pikë përqindjeje në rritjen e të ardhurave totale.

[34] *Deri në muajin maj janë shlyer rreth 60% e detyrimeve të prapambetura të planifikuara për gjithë vitin. Rreth 43% e tyre konsistojnë në detyrime të infrastrukturës, ndërsa rreth 34% përbëhen nga detyrime të prapambetura tatimore.*

[35] *Që prej datës 1 janar 2015, pas ndryshimeve ligjore, norma e tatimit për fitimet nga depozitat në sistemin bankar u rrit në 15%, nga 10% që ishte deri para kësaj date.*

[36] *Më datë 1 janar hyri në fuqi Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.23, datë 9.12.2014 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore" nëpërmjet të cilit u vendos rritja e pagës minimale mbi të cilën llogariten detyrimet për të deklaruarit si të vetëpunësuar dhe për punonjësit e papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin. Kjo rritje, bashkë me rritjen e efektivitetit të administratës tatimore, ka sjellë edhe rritjen e të ardhurave nga kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore.*

[37] *Të ardhurat nga akcizat pasqyrojnë rritjen e normës së aplikuar tek karburantet dhe efektin bazë të një viti më parë. Në vitin 2014 filloi aplikimi i tarifave të rritura për mallrat e importit nga akciza. Duke qenë se bizneset i kishin paraprirë këtij fenomeni në fund të vitit 2013, të ardhurat nga akciza për tremujorin e parë të vitit 2014 kanë qenë në nivele të ulëta.*

[38] *Të ardhurat jotatimore kanë pasqyruar rritjen e shpejtë të të ardhurave nga institucionet buxhetore, që pasqyrojnë shitjen e licencës për ofrimin e shërbimit 4G nga një nga operatorët e telefonisë celulare.*

Grafik 35. Ndryshimi vjetor i të ardhurave sipas kontributeve të zërave kryesorë (majtas), dhe ndryshimet vjetore të zërave kryesorë të të ardhurave (djathtas)



Burimi: Ministria e Financave.

Deficiti buxhetor arriti në rreth 9.8 miliardë lekë në pesë muajt e parë të vitit, duke u ngushtuar me rreth 17.8%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky deficit është financuar në pjesën më të madhe nga burimet e huaja. Huamarrja e brendshme në këtë periudhë ka arritur në 11.7 miliardë lekë. Një pjesë e fondeve të marra hua është pasqyruar në rritjen e gjendjes së llogarisë së qeverisë në Bankën e Shqipërisë.

Grafik 36. Shuma rrëshqitëse 12-mujore e deficitit (majtas) dhe instrumentet e financimit të tij, në mld lekë (djathtas)



Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, llogaritje të stafit.

4.2.5. KËRKESA E HUAJ DHE TREGTIA E JASHTME

Deficiti real tregtar në mallra dhe në shërbime u ngushtua në tremujorin e parë të vitit 2015. Zvogëlimi vjetor me 15% i deficitit tregon një vazhdim të prirjes së nisur gjatë një tremujori më parë. Ecuria e eksporteve neto vlerësohet të ketë dhënë një kontribut pozitiv prej 2.8 pikë përqindjeje në rritjen vjetore

Grafik 37. Kontributi i eksporteve neto në kërkesën agregate (në pikë përqindje)



Burimi: INSTAT.

të kërkesës agregate. Këtu ndikim të qenësishëm dha rritja vjetore e eksportit real të shërbimeve. Në vijimësi të rezultateve për tremujorin e parë të vitit, projeksionet tona për vitin 2015 janë rishikuar për lart. Ato sinjalizojnë një kontribut të lehtë pozitiv të sektorit të jashtëm në rritjen e kërkesës agregate.

Për tremujorin e dytë të vitit 2015, të dhënat mbi ecurinë e eksporteve neto përfshijnë vetëm përbërësin e tregtisë në mallra për muajt prill dhe maj. Deficiti tregtar në mallra për këto dy muaj u ngushtua me rreth 3.3% në terma vjetorë, ku rënia e importeve me 5% në nivel vjetor ishte faktori përcaktues.

Grafik 38. Orientimi i importeve dhe eksporteve sipas kategorive (vlera në milionë lekë)



Burimi: INSTAT

Eksporti i mallrave në vlerë u zvogëlua me rreth 6.6% në nivel vjetor. Kontributin kryesor në këtë ecuri e dha rënia e eksportit të kategorisë "Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike". Brenda kësaj kategorie, ndikimin më të madh e ka dhënë përgjysmimi i eksportit të naftës krahasuar me një vit më parë. Në anën tjetër, eksporti i energjisë elektrike u zgjerua me ritme të përshpejtuara. Në kushtet e konjukturave të pafavorshme të çmimit në tregjet ndërkombëtare të mallrave bazë të metalit, eksporti i kategorisë "Materiale ndërtimi dhe metale" është zvogëluar. Në anën tjetër, eksportet e prodhimeve bujqësore rezultuan rreth 33% më të larta këto dy muaj, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Eksporti i produkteve me material porositësi u zvogëlua. Megjithatë, të shpërndarë sipas muajve, eksporti i këtyre produkteve njohu rënie vjetore në muajin prill dhe rritje të lehtë vjetore në muajin maj.

Aktiviteti importues rezultoi në rënie me rreth 5.0%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Dinamika e importeve u përcaktua gjerësisht prej tkurrjes me rreth 32.6% të importit të mallrave të përfshira në kategorinë "Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike". Situata e favorshme energjetike arriti të mbulojë kërkesën vendase për energji elektrike, duke kontribuar në kahun rënës të importeve totale. Në të kundërt, kategoria e mallrave të përfshira në "Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi" regjistroi rritje me rreth 7.5% në terma vjetorë. Ecuria pozitive e kësaj kategorie vlerësohet të lidhet ngushtë me ecurinë e formimit bruto të kapitalit fiks për tremujorin e dytë të vitit. Importet e mallrave që lidhen drejtpërdrejt me prodhimin në industritë tekstile me material porositësi u rritën me rreth 4.7% në terma vjetorë gjatë periudhës së konsideruar.

Sipas orientimit gjeografik, eksportet vijojnë të jenë të orientuara drejt tregjeve të Italisë, të Kosovës, të Spanjës dhe të Maltës. Origjina e produkteve të importuara paraqitet më e larmishme, ku vendet e BE-së mbajnë historikisht peshën kryesore ndaj totalit të importeve (59.2% gjatë pesë muajve të parë të vitit 2015). Në periudhën prill –maj, aktiviteti tregtar me Greqinë rezultoi në rënie si në importe, ashtu edhe në eksporte.

Hapësirë informuese 4. Zhvillimet në bilancin e pagesave në tremujorin e parë të vitit 2015

Pozicioni neto i llogarisë korrente regjistroi një deficit prej 230 milionë eurosh në tremujorin e parë të vitit 2015. Pas pesë tremujorësh radhazi me prirje thelluese, deficiti korrent u ngushtua me rreth 15.3% në nivel vjetor. Ai u vlerësua në nivelin 10.1% ndaj PBB-së nominale. Sipas zërave përbërës të llogarisë korrente, kontribut në kahun ngushtues dhanë përmirësimi i bilancit të eksporteve neto dhe të ardhurat dytësore më të larta, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Deficiti i të ardhurave parësore vijoi prirjen thelluese për të gjashtin tremujor radhazi. Ky i fundit dha ndikim të kahut zgjerues në ecurinë vjetore të deficitit të llogarisë korrente. Në terma strukturorë, i matur sipas hendekut kombëtar midis kursimeve dhe investimeve, sektori privat luajti rol kryesor në formimin e deficitit korrent.

Flukset hyrëse neto në llogarinë kapitale u rritën në 26 milionë euro, nga 22.5 milionë euro që ishin gjatë tremujorit të parë të vitit të kaluar. Flukset valutore neto në llogarinë financiare, u zvogëluan me rreth 10.1% në nivel vjetor dhe financuan 77.8% të deficitit të llogarisë korrente. Investimet e huaja direkte neto u zgjeruan me rreth 53.4% në terma vjetorë dhe e financuan tërësisht deficitin korrent. Në anën tjetër, investimet e tjera neto u vlerësuan në një tepricë neto pozitive prej rreth 61.2 milionë eurosh, ndikuar kryesisht nga rritja e mjeteve vendase të investuara jashtë. Në të kundërt, investimet e portofolit neto u zvogëluan me rreth 94.1 milionë euro. Në ndarjen e financimit të deficitit korrent sipas flukseve financiare borxhkrijuese dhe joborxhkrijuese, vërehet një mbështetje më e theksuar ndaj formës së dytë të financimit.

Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me zgjerim të mjeteve të rezervës valutore me 111.8 milionë euro. Në fund të muajit mars, stoku i rezervës valutore ishte rreth 2.4 miliardë euro. Ky nivel ishte i mjaftueshëm për mbulimin me 5.3 muaj import mallrash dhe shërbimesh dhe për mbulimin e 192% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.

Tabelë 3. Tregues të bilancit të pagesave (në miliardë euro)

	T3 '13	T4 '13	T1 '14	T2 '14	T3 '14	T4 '14	T1 '15
Llogaria korrente (në mil euro)	-191.0	-337.0	-271.5	-341.0	-313.2	-377.5	-230.0
vmv (%)	-22.9	63.7	21.3	19.5	64.0	12.0	-15.3
/ PBB-së (%)	-8.2	-13.4	-11.7	-12.8	-12.6	-14.5	-10.1
Mallra dhe shërbime	-395.4	-518.9	-396.2	-473.3	-462.8	-536.0	-365.6
Eksporte, f.o.b.	861.3	808.7	608.8	752.0	838.8	757.1	624.4
Importe, f.o.b.	1256.8	1327.6	1005.0	1225.3	1301.6	1293.1	990.0
Udhëtime neto	26.1	34.0	-21.8	10.6	32.0	66.0	43.6
Të ardhura parësore	22.2	0.0	-20.6	-43.3	-48.7	-47.0	-49.3
Kredi	40.2	33.4	28.7	25.7	28.3	27.8	22.9
Debi	18.0	33.4	49.3	69.1	77.0	74.8	72.3
Të ardhura nga IHD-neto	6.2	6.9	-30.4	-47.1	-56.2	-38.6	-52.0
Të ardhura dytësore	182.3	181.9	145.3	175.6	198.3	205.4	184.9
Kredi	216.5	213.5	172.6	204.4	230.6	244.1	216.1
Debi	34.2	31.6	27.3	28.8	32.3	38.8	31.2
Dërgesa nga emigrantët -neto	152.5	140.1	118.2	137.5	165.1	171.0	146.0
Llogaria Kapitale	15.0	18.2	22.5	22.4	20.7	21.1	26.0
Huamarrje neto/Huadhënie neto	-175.9	-318.8	-249.0	-318.7	-292.5	-356.4	-204.1
Llogaria financiare	-70.9	-226.1	-199.1	-214.5	-206.1	-285.9	-179.0
vmv (%)	78.4	-16.2	57.2	-18.3	190.7	26.5	-10.1
/ PBB-së (%)	-3.0	-9.0	-8.6	-8.0	-8.3	-10.9	-7.9
Investime direkte	-307.0	-231.2	-168.0	-150.4	-253.4	-229.4	-257.9
Investime portofoli	6.2	-18.1	14.5	14.0	-12.4	104.7	-94.1
Derivativë financiarë	0.0	-2.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Investime të tjera	195.4	18.6	-5.2	-100.6	-94.2	-122.2	61.2
Mjetet e rezervës	34.5	7.1	-40.3	22.5	154.0	-38.9	111.8
Gabime dhe harresa	105.1	92.7	49.9	104.2	86.4	70.5	25.1
Huamarrje neto/Huadhënie neto	-175.9	-318.8	-249.0	-318.7	-292.5	-356.4	-204.1

Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.3. GJENDJA CIKLIKE E EKONOMISË

Ekonomia shqiptare vazhdon të karakterizohet nga kapacitete të pashfrytëzuara, të cilat gjenerojnë presione të ulëta inflacioniste. Projeksionet tona sugjerojnë një rikuperimin gradual por progresiv të normave të rritjes drejt potencialit dhe një mbyllje të hendekut negativ të prodhimit në vitin 2016.

Pavarësisht rritjes në tremujorin e parë, ekonomia shqiptare vazhdon të karakterizohet nga kapacitete të pashfrytëzuara në tregun e punës dhe të kapitalit. Prania e kapaciteteve të pashfrytëzuara në ekonomi reflektohet në normën ende të lartë të papunësisë (17.3 %) dhe në normën e shfrytëzimit të kapaciteteve, e cila mbetet poshtë mesatares historike. Dobësia ciklike e ekonomisë frenon rritjen e pagave e të kostove të prodhimit e të punës, si dhe mban në nivele të ulëta marzhet e fitimit të bizneseve.

Në tremujorin e dytë, rritja e normës së shfrytëzimit të kapaciteteve dhe e treguesit paraprijës sugjeron për përdorim më intensiv të kapaciteteve prodhuese dhe vijim të përmirësimit ciklik të ekonomisë. Projeksionet tona flasin për rritjen progresive të ekonomisë dhe për mbylljen graduale të hendekut negativ të

prodhimit gjatë vitit të ardhshëm. Presionet inflacioniste nga kërkesa dhe ekonomia e brendshme parashikohen të vijnë në rritje, duke kthyer inflacionin në objektiv në afat të mesëm.

Grafik 39. Tregues të gjendjes ciklike të ekonomisë



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

*Hapësirë informuese 5. Ekspozimi i ekonomisë shqiptare ndaj zhvillimeve në Greqi**

Negociatat e gjata të Greqisë me kreditorët e saj ndërkombëtarë krijuan vështirësi në ekonominë greke. Pas dështimeve të rregullta për të arritur një marrëveshje për reformat e propozuara dhe pas rezultatit të referendumit të thirrur papritur nga qeveria greke, pasiguria për të ardhmen ekonomike e financiare të Greqisë u rrit ndjeshëm. Duke iu trembur panikut në vend, qeveria greke vendosi të lejojë vetëm një nivel tavan ditor prej 60 eurosh për t'u tërhequr prej bankave të nivelit të dytë në vend, të mbyllë bursën e bankat për një periudhë të pacaktuar, e të ndërmarrë kontrolle kapitali në vend. Zhvillimet e javëve të fundit janë reflektuar në rritjen e luhatjes së tregjeve financiare dhe të kapitalit në Eurozonë.

Më 13 korrik 2015, diskutimet midis forumit të ministrave të financave të vendeve të Eurozonës dhe Greqisë, u përmbyllën me aprovimin në parim të një pakete mbështetjeje financiare, të kushtëzuar prej reformave të caktuara që duhet të ndërmarrë Greqia. Pas lajmërimit për arritjen e marrëveshjes, kushtet në tregjet financiare u përmirësuan; bankat e nivelit të dytë u rihapën, ndonëse niveli tavan i tërheqjeve për person dhe politikat mbi kontrollet e kapitalit dhe mbi mbylljen e bursës mbetën në fuqi. Zgjidhja e ngërçit në Greqi pritet të përfundojë në muajt në vazhdim dhe situata ekonomike të rikthehet në normalitet. Megjithatë, ne gjykojmë që ekonomia shqiptare do të përjetojë një ndikim direkt në ekonominë reale gjatë gjysmës së dytë të vitit.

*Pavarësisht ekspozimit të vogël direkt, situata në Greqi vlerësohet të reduktojë rritjen tonë ekonomike në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2015. Ekspozimi i ekonomisë shqiptare ndaj Greqisë është reduktuar progresivisht gjatë viteve të fundit pas krizës ekonomike e financiare të vitit 2008. Bankat me kapital grek përbëjnë rreth 15% të totalit të sistemit bankar shqiptar, krahasuar me 25% në fund të vitit 2008. Stoku i investimeve të huaja direkte nga Greqia ishte rreth 26% në vitin 2013, i zvogëluar me 1 pikë përqindjeje nga viti 2008. Pesha e remitancave prej Greqisë vlerësohet të ketë rënë nga 45% e totalit në vitin 2008, në rreth ¼ e totalit në vitin 2014**.*

Në të njëjtën kohë, diversifikimi gjeografik i eksporteve shqiptare ka sjellë reduktimin e peshës që zënë eksportet ndaj Greqisë. Eksporti i mallrave drejt Greqisë është zvogëluar nga 8.8% ndaj totalit në vitin 2008 në rreth 3.5% në vitin 2014.

*Kanalet direkte të ndikimit të krizës greke në Shqipëri, pritet të jenë më tepër të lidhura me sektorin real – në formën e goditjeve mbi eksporte dhe mbi remitanca - se me atë financiar.*** Banka e Shqipërisë ka kryer një vlerësim paraprak të ndikimit të mundshëm të reduktimit apo frenimit të tyre mbi ritmet e rritjes ekonomike të gjashtëmujorit të dytë të vitit.*

Analiza e eksporteve të mallrave tregon se përafërsisht gjysma e eksportit tonë drejt Greqisë përbëhet nga mallra të ndërmjetme. Këto lloj mallrash pritet të mos ndikohen qenësisht nga situata aktuale në Greqi, duke qenë se shkëmbimi i tyre rregullohet me kontrata më afatgjata në kohë. Nga ana tjetër, eksporti i mallrave të konsumit, i cili rregullohet me kontrata afatshkurtra do të jetë segmenti që do të vuajë përkohësisht prej vështirësive ekonomike e financiare në vendin fqinj. Për rrjedhojë, eksporti i mallrave drejt Greqisë mund të përgjysmohet. Eksporti i shërbimeve është i lidhur ngushtë me profilin e eksportit të mallrave. Shërbimet e transportit, komunikimit e sigurimit pritet të ndikohen paralelisht prej goditjes së eksportit me Greqinë. Për këtë arsye, ne gjykojmë që një goditje e madhësisë së njëjtë me atë të eksportit të mallrave është e aplikueshme edhe për eksportin në shërbime. Më tej, si rrjedhojë e vendosjes së kufizimeve mbi bankat e mbi lirinë e lëvizjes së kapitalit, remitancat nga Greqia mund të ndërpriten gjatë dy tremujorëve të fundit të vitit.

Duke faktorizuar vetëm efektet direkte të kanaleve të mësipërme, modelet tona të parashikimit sugjerojnë se rritja ekonomike në Shqipëri do të reduktohet me mesatarisht 0.25 pikë përqindje për vitin aktual.

* *Përgatitur nga R. Hoxholli dhe E. Kika, Departamenti i Politikës Monetare.*
** *Këto janë vlerësime paraprake bazuar në vrojtimet e Bankës së Shqipërisë.*
*** *Të dhënat e fundit tregojnë se sistemi bankar shqiptar nuk është i ekspozuar ndaj sektorit publik grek apo ndaj grupeve private greke.*

4.4. ECURIA E INFLACIONIT

Luhatjet e inflacionit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015 u përcaktuan në masën më të madhe nga luhatjet e çmimeve të mallrave ushqimore. Kategoria "Ushqime të papërpunuara" përcaktoi kahun e luhatjeve të inflacionit gjatë këtij gjashtëmujori. Rritja në periudhën shkurt–mars e çmimeve të mallrave të kësaj kategorie, pësoi një frenim gjatë muajve maj-qershor. Si rezultat, kontributi i kësaj kategorie te inflacioni total u ul nga 2.3 pikë përqindje në muajin prill, në 1.3 pikë përqindje në muajin qershor. Faktori kryesor që ka ndikuar në këtë lëvizje vlerësohet të jetë plotësimi në rritje i kërkesës për këto mallra nga oferta vendase. Kategoria "Ushqime të përpunuara" kontribuoi me 0.2 pikë përqindje në formimin e inflacionit total vjetor. Pas rregullimeve të reja fiskale në çmimet e disa prej këtyre mallrave, në tremujorin e dytë të vitit, filloi rënia e çmimeve edhe për mallrat e kësaj kategorie.

Kategoritë "Mallra me çmime të rregulluara" dhe "Shërbime" kontribuan përkatësisht me 0.1 pikë përqindje në formimin e inflacionit të tremujorit të dytë. Kategoritë e tjera rezultojnë në një kontribut total në vlera negative te norma totale e inflacionit. Çmimet e qirave erdhën në rënie gjatë tremujorit të dytë, dhe të njëjtën ecuri ndoqi edhe kontributi i kësaj kategorie në inflacionin total. Gjithashtu, kategoria "Mallra konsumi joushqimor" vazhdon të ketë një tendencë inflacioni në rënie, por dëshmon njëkohësisht edhe luhatshmëri të lartë të kontributit në inflacionin total.

Grafik 40. Kontributet sipas kategorive ushqimore dhe joushqimore në inflacionin vjetor total



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Tabelë 4. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)

	T2:13	T3:13	T4:13	T1:14	T2:14	T3:14	T4:14	T1:15	T2:15
Ushqime të përpunuara (pp)	0.3	0.1	-0.1	-0.1	-0.2	-0.1	0.2	0.3	0.2
Bukë dhe drithëra (pp) *	0.1	0.1	0.0	-0.1	-0.1	-0.1	-0.1	0.0	0.0
Alkool dhe duhan (pp)	0.2	0.1	0.1	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3
Ushqime të papërpunuara (pp)	2.0	1.5	1.5	1.6	1.3	1.5	0.8	1.7	1.8
Fruta (pp)	0.4	0.8	0.5	0.7	0.7	0.2	0.4	0.5	0.8
Perime(pp)	1.5	0.5	1.1	0.9	0.6	1.2	0.2	1.1	0.9
Shërbime (pp)	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2	0.1	0.1
Mallra me çmime të rregulluara (pp)	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	-0.1	0.1	0.1	0.1
Lëndë djegëse dhe energji (pp)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Strehim (pp)	-0.1	0.0	0.3	0.3	0.2	0.1	0.1	0.1	-0.1
Mallra konsumi joushqimore	-0.3	-0.4	-0.2	0.2	0.2	0.2	0.0	-0.4	-0.3
Mallra konsumi afatgjatë (pp)	0.1	0.0	0.0	-0.1	-0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
Indeksi i çmimeve të konsumit (v/v %)	2.2	1.5	1.5	1.9	1.6	1.7	1.3	1.9	1.8

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.
**Në tabelë janë paraqitur disa nga grupet kryesore të kategorive.*

4.4.1. PËRBËRËSIT AFATGJATË TË INFLACIONIT

Ecuria e ulët e inflacionit vazhdon të diktohet, në masën më të madhe, nga dobësia ciklike e ekonomisë shqiptare, e cila reflektohet në rritje të ulët të pagave, të kostove të prodhimit dhe të inflacionit bazë. Inflacioni bazë dhe ai i sektorit të patregtueshëm të IÇK-së rezultuan përkatësisht rreth 0.3% dhe 0.4% në tremujorin e dytë të vitit 2015.[39] Prirjet e lehta rritëse të përbërësve të mësipërm të inflacionit në fillim të vitit nuk vijuan në tremujorin e dytë. Përgjatë kësaj periudhe, inflacioni bazë dhe ai i sektorit të patregtueshëm shënuan reduktime graduale, si pasojë e rënies së çmimeve në disa shërbime. Nga ana tjetër, ngadalësimi i inflacionit afatgjatë u shoqërua edhe nga reduktimi

[39] *Inflacioni bazë rezulton si mesatare e thjeshtë e dy matjeve: me përjashtim të përhershëm të të njëjtëve artikuj të shportës; dhe me mesatare të reduktuar. Inflacioni i patregtueshëm dhe ai i tregtueshëm u referohen ndryshimeve në IÇK-të e nënshportave përkatëse, ku ajo e të patregtueshmeve përbëhet kryesisht nga shërbime dhe mallra, ndërsa ajo e të tregtueshmeve vetëm nga mallra.*

i përbërësve afatshkurtër, të cilët ndikohen nga goditje të ofertës apo nga zhvillimet e tregut ndërkombëtar. Kështu, inflacioni vjetor jobazë rezultoi 4.9%, ndërsa inflacioni i mallrave të tregtueshme rezultoi në terma relativisht të ulët historikë (2.7%).

Grafik 41. Prirjet afatgjata (majtas) dhe afatshkurtra të inflacionit (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Zhvillimet e mësipërme në prirjen afatgjatë dhe të brendshme të inflacionit, reflektojnë intensitetin ende të ulët dhe të paqëndrueshëm të presioneve nga ana e kërkesës gjatë gjysmës së parë të vitit 2015.

Grafik 42. Ndryshimet vjetore mesatare të produktivitetit, të kostove të punës dhe të prodhimit *



*Shënim: Për treguar prirjet e treguesve, ndryshimet vjetore të tyre janë shesuar me mesataret lëvizëse me 4 terma (MA).
Burimi: INSTAT dhe llogaritje të BSh-së.

PAGAT, PRODUKTIVITETI DHE KOSTOT E PUNËS E TË PRODHIMIT[40]

Kostot e punës për njësi (KPNj) shënuan frenim të ritmeve rritëse (5.9%) në tremujorin e parë të vitit. Ky ngadalësim reflektoi stabilizimin e tendencave negative të treguesit të produktivitetit të punës dhe një reduktim më të ulët të pagës mesatare reale. Në të njëjtën periudhë, edhe ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të prodhimit (IÇP) industrial regjistroi rënie më të thellë sesa në tremujorët e kaluar (-0.9%). Zhvillimet në këta tregues vijojnë të tregojnë praninë e presioneve inflacioniste të dobëta nga krahu i pagave dhe i kostove prodhuese në sektorët jobujqësorë të ekonomisë.

[40] *Treguesit e pagës mesatare, e produktivitetit të punës dhe ai i kostove të punës për njësi të prodhuar, llogariten nga Banka e Shqipërisë, nga seritë e Statistikave Afatshkurtra të T1'2015 (SASH, INSTAT). Në përllogaritjen e tyre përfshihen: indeksi i punësimit, i xhiros dhe i fondit të pagave, për aktivitetin jobujqësor. Treguesi i pagës mesatare llogaritet si raport i indeksit të fondit të pagave me indeksin e numrit të punonjësve (duke përjashtuar sektorin bujqësor dhe të vetëpunësuarit me pagesë). Në terma realë, indeksi i pagës mesatare deflatohet me indeksin e çmimeve të konsumit.*

4.4.2. INFLACIONI I IMPORTUAR

Presionet inflacioniste me prejardhje nga partnerët tregtarë u pozicionuan në kahun rënës në tremujorin e dytë. Në kushtet e normave të ulëta të inflacionit në vendet e Bashkimit Evropian, presionet për çmime të larta nga jashtë u gjeneruan nga vende jashtë BE-së (si Turqia dhe Serbia). Indeksi i "Çmimeve të huaja"[41] u rrit me vetëm 1.6% në terma vjetorë, niveli më i ulët që prej tremujorit të fundit të vitit 2013. Rol kyç në përcjelljen e ecurisë së çmimeve jashtë në inflacionin në vend ka luajtur nënçmimi i lekut në terma të indeksit NEER (me rreth 3.0%). Për efekt të këtyre dy komponentëve, indeksi TPHI[42] u rrit me 4.7% në terma vjetorë, nga 6.6% në tremujorin e parë. Ecuria e indeksit TPHI nënkupton një rritje më të ngadaltë të presioneve të huaja inflacioniste.

Në terma historikë, kontributi i inflacionit të importuar në atë total mbetet i ulët. Kjo dukuri vjen falë efektit integral të çmimeve të ulëta të lëndëve të para në tregjet e ndërkombëtare.

Grafik 43. TPHI dhe kontributet e përbërësve të tij (majtas); kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm në atë total vjetor (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

[41] *Është një tregues përafrues mbi presionet e huaja inflacioniste, i krahasueshëm me inflacionin e sektorit të tregtueshëm të mallrave të shportës së IÇK-së vendase. Indeksi i çmimeve të huaja bazohet në vlerat: e inflacionit të kategorisë "Ushqim, pije, duhan" për 18 shtete kryesore; dhe inflacionit të "Mallrave" (pra, jo vetëm Ushqime) për Bullgarinë, Gjermaninë, Greqinë, Italinë dhe Turqinë. Disa nga mallrat kanë shënuar rritje vjetore të çmimeve, ndërsa janë rritur edhe peshat e importeve me shtetet përkatëse. Kjo ka ndikuar që vlera përfundimtare e treguesit (mesatare e ponderuar e IÇK-ve të lartpërmendura me peshat mujore të importit të tyre), të shënojë një rritje jo pak të rëndësishme.*

[42] *TPHI-ja llogaritet si rritja vjetore e indeksit të çmimeve të huaja dhe indeksit NEER për muajin përkatës. Presionet inflacioniste me origjinë të huaj vlerësohet që ndikojnë inflacionin me 1-3 muaj vonesë.*

4.4.3. PRITJET INFLACIONISTE[43]

Pritjet inflacioniste kanë qëndruar poshtë objektivit dhe poshtë mesatares së tyre afatgjatë. Sipas matjeve të ndryshme nga vrojtimet, pritjet afatshkurtra të konsumatorëve dhe të bizneseve qëndrojnë në nivelet më të ulëta historike në tremujorin e dytë të vitit.[44] Pritjet afatmesme të inflacionit, të matura nga vrojtimi i agjentëve financiarë, kanë shkallën më të mirë të ankorimit në objektivin e Bankës së Shqipërisë prej 3% dhe afër mesatares së tyre afatgjatë.

Dinamika tremujore e matjeve të pritjeve paraqitet e ndryshme për agjentë të ndryshëm të ekonomisë në tremujorin e dytë. Pritjet inflacioniste të agjentëve financiarë janë rishikuar për lart. Inflacioni i pritur prej tyre pas një viti qëndron në nivelin 2.3%, rreth 0.4 pikë përqindje më lart se tremujori i mëparshëm. Pritjet afatmesme shënuan 2.5%, në rritje me 0.5 pikë përqindje, duke iu afruar ndjeshëm mesatares afatgjatë (3%) për herë të parë që nga tremujori i tretë i vitit 2013. Pritjet inflacioniste të konsumatorëve u rishikuan për poshtë në tremujorin e dytë, duke vijuar prirjen rënëse të katër tremujorëve të fundit. Aktualisht, inflacioni i pritur i tyre pas një viti është 1.3%, 0.9 pikë përqindje më i ulët se mesatarja historike prej 2.1%. Inflacioni i pritur pas një viti nga bizneset mbeti i pandryshuar nga tremujori i parë në nivelin 1.5%, 0.7 pikë përqindje nën mesataren afatgjatë.

Grafik 44. Pritjet inflacioniste nga agjentë të ndryshëm të ekonomisë



Burimi: Banka e Shqipërisë

[43] *Analiza mbi pritjet inflacioniste bazohet në rezutatet e vrojtimit të besimit të bizneseve dhe të konsumatorëve, me frekuencë tremujore, si dhe në vrojtimin e pritjeve të agjentëve financiarë, me frekuencë mujore.*

[44] *Përkatësisht 2 dhe 3 devijime standarde nën mesataren e vet historike.*

Tregues të përgjithshëm makroekonomikë	54	MAIN MACROECONOMIC INDICATORS
1. Zhvillimet monetare dhe normat e interesit	54	Monetary developments and interest rates 1.
2. Prodhimi i brendshëm bruto, indekset e çmimeve dhe tregu i punës	54	Gross domestic product, price indexes and labor market 2.
3. Bilanci i pagesave, rezerva dhe kursi i këmbimit	55	Balance of payments, reserves and exchange rate 3.
4. Bilanci fiskal, stoku i borxhit të brendshëm dhe borxhi i jashtëm	55	Fiscal balance, domestic debt stock and external debt 4.
1 SEKTORI FINANCIAR	56	FINANCIAL SECTOR 1
1-1 Bilanci sektorial i Bankës së Shqipërisë	56	Sectoral balance sheet of Bank of Albania 1-1
1-2 Paraqitja monetare e Bankës së Shqipërisë	57	Monetary survey of Bank of Albania 1-2
1-3.a Bilanci sektorial i bankave paradepozituese/ Mjetet	58	Sectoral balance sheet of money deposit banks/ Assets 1-3.a
1-3.b Bilanci sektorial i bankave paradepozituese/ Detyrimet	59	Sectoral balance sheet of money deposit banks/ Liabilities 1-3.b
1-4 Paraqitja monetare e bankave paradepozituese	60	Monetary survey of deposit money banks 1-4
1-5 Bilanci sektorial i shoqërive të kursim-kreditit	61	Sectoral balance sheet of savings and loan associations 1-5
1-6 Paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese	62	Monetary survey of other depository corporations 1-6
1-7 Paraqitja monetare e korporatave depozituese	63	Monetary survey of depository corporations 1-7
1-8.a Agregatët monetarë dhe përbërësit e tyre	64	Monetary aggregates and their components 1-8.a
1-8.b Kundërpartitë e agregatëve monetarë	65	Counterparts of monetary aggregates 1-8.b
1-9 Depozitat në lekë sipas sektorëve	66	Lek denominated deposits by sector 1-9
1-10 Depozitat në valutë sipas sektorëve	66	Foreign currency denominated deposits by sector 1-10
1-11 Kredia për ekonominë sipas sektorit	67	Credit to economy by sector 1-11
1-12 Kredia sipas aktivitetit ekonomik	67	Loans by economic activity1 1-12
1-13 Kredia për bizneset sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	68	Business loans by purpose and currency 1-13
1-14 Kredia për individët sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	69	Household loans by purpose and currency1 1-14
1-15 Kredia sipas rretheve	70	Loans by districts 1-15
1-16 Normat bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë	70	Bank of Albania interest rates 1-16
1-17 Normat e interesit për depozitat e reja sipas monedhave	71	Interest rates on new deposits by currency 1-17
1-18 Normat e interesit për kreditë e reja sipas monedhave	72	Interest rates on new loans by currency 1-18
1-19 Normat e interesit për bonot e thesarit sipas afatit	73	Maturity breakdown of Treausury bill yields 1-19
1-20 Sistemi i pagesave ndërbankare	74	Interbank payment system 1-20
1-21 Shpërndarja rajonale e terminaleve të ATM & POS	74	Number of ATM & POS terminals by region 1-21
1-21 Tregues të kapitalit dhe cilësisë së aktiveve	74	Indicators of capital and assets quality 1-21
1-22 Numri i llogarive të klientëve në banka	74	Number of customers accounts with banks 1-22
2 SEKTORI I JASHTËM	75	EXTERNAL SECTOR 2
2-1A Bilanci i Pagesave	75	Balance of payments 2-1A
2-1B Bilanci i Pagesave	75	Balance of payments 2-1B
2-2 Kurset e këmbimit të lekut kundrejt monedhave kryesore	76	Exchange rate 2-2
2-3 Eksporti sipas grup mallrave	76	Export by commodity groups 2-3
2-4 Importi sipas grup mallrave	77	Import by commodity groups 2-4
2-5 Borxhi i jashtëm bruto	77	Gross external debt 2-5
3 SEKTORI FISKAL	78	FISCAL SECTOR 3
3-1 Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar	78	Fiscal indicators regarding consolidated budget 3-1
3-2 Stoku i borxhit të brendshëm sipas instrumenteve	78	Domestic debt stock by instruments 3-2
4 SEKTORI REAL	79	Real Sector 4
4-1 Prodhimi i brendshëm bruto sipas aktivitetit ekonomik	79	Gross domestic product by economic activities 4-1
4-2 Indeksi i çmimeve të prodhimit dhe indeksi i kushtimit në ndërtim (për banesa)	80	Producer price index and construction cost index 4-2 (for dwellings)
Ndryshimet në përqindje të indeksit të çmimeve të prodhimit dhe të indeksit të kushtimit në ndërtim (për banesa)	80	Change in % of producer price index and construction cost (for dwellings) index
4-3 Indeksi i çmimeve të konsumit	81	Consumer price index 4-3
4-4 Punësimi, papunësia dhe pagat	82	Employment, unemployment and wages 4-4

1. ZHVILLIMET MONETARE DHE NORMAT E INTERESIT NË MILIARDË LEKË, PËRVEÇ RASTEVE KUR SHËNOHET NDRYSHE, FUND PERIUDHE

MONETARY DEVELOPMENTS AND INTEREST RATES 1. IN BILLIONS ALL, UNLESS OTHERWISE INDICATED, END OF PERIOD

	Agregatët monetarë / Monetary aggregates			Depozitat[1] / Deposits[1]	Kredia[2] / Credit[2]	Normat e interesit 12m / 12m interest rates (%)			Norma e marrëveshjes së riblerjejes njëjavore [4] / Weekly repurchase agreement rate[4]
	M1	M2	M3			Depozita[3] / Deposits[3]	Kredi[3] / Loans[3]	Bono Thesari/ T. Bills	
	1	2	3	4	5	6	7	8	9
2010	275.4	604.5	980.3	785.2	483.1	6.40	11.29	7.09	5.00
2011	276.9	647.0	1,070.1	875.2	541.9	5.87	11.17	6.95	4.75
2012	281.2	669.6	1,123.4	930.7	554.7	5.38	10.28	6.37	4.00
2013	295.9	693.2	1,149.0	950.1	547.9	4.17	9.52	3.66	3.00
2014	353.3	722.4	1,195.1	977.4	560.0	1.92	7.66	3.33	2.25

Burimi: Banka e Shqipërisë. *Source: Bank of Albania.*

2. PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO[3], INDEKSET E ÇMIMEVE DHE TREGU I PUNËS

GROSS DOMESTIC PRODUCT[3], PRICE INDEXES AND LABOR MARKET

	Rritja reale vjetore e PBB me çmime konstante (%)/ Annual real growth of GDP at constant prices (%)	Me çmime korrente, në milionë lekë [6] / At current prices, in million ALL [6]				Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të konsumit (%) / Yearly changes in CPI (%)	Ndryshimet Mesatare Vjetore të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit (NVE Rev.2) % Average Annual Changes of Producer Price Index (NACE Rev.2) %	Tregu i punës[6] / Labor market[6]	
		Produkti Brendshëm Bruto (PBB) / Gross domestic product (GDP)	Pagat e të punësuarve, neto /Compensation of employees, net	Të Ardhura nga prona, neto / Property income, net	Të Ardhurat Kombëtare Bruto / Gross National Income			Shkalla e punësimit / Employment rate (%)	Shkalla e papunësisë / Unemployment rate (%)
	1	2	3	4	5=2+3+4	6	7	8	9
2010	3.7	1,239,644.6	22,494.7	-34,879.1	1,227,260.2	3.6	0.3	53.5	14.2
2011	2.5	1,300,624.1	18,020.7	-21,612.7	1,297,032.1	1.7	2.6	58.7	14.3
2012	1.4	1,332,811.0	12,441.5	-22,369.0	1,322,883.5	2.4	1.1	55.9	13.8
2013	1.1	1,350,554.8	1,793.9	1,165.6	1,353,514.3	1.9	-0.4	49.9	16.4
2014						0.7	-0.5	50.5	17.9

Burimi: INSTAT. *Source: INSTAT.*

3. BILANCI I PAGESAVE, REZERVA DHE KURSI I KËMBIMIT NË MILIONË EURO, PËRVEÇ RASTEVE KUR SHËNOHET NDRYSHE

BALANCE OF PAYMENTS, RESERVES AND EXCHANGE RATE 3. IN MILLIONS EUR, UNLESS OTHERWISE INDICATED

	Bilanci i llogarisë korrente / Current account	Nga të cilat: Bilanci tregtar / Of which:Trade balance (3+4)			Nga të cilat: Remitancat / Of which: Remittances	Investimet direkte neto / Direct investments, net	Rezervat valutore (stok)/ Reserves (stock)	Rezervat në muaj importe / Reserves in months of import	Kursi i këmbimit / Exchange rate	
			Eksporti / Export	Importi / Import					Mesatare e periudhës / Period average	
									ALL / EUR	ALL / USD
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
2010 [7]	-1,018.6	-2,082.7	1,171.5	-3,254.2	689.8	788.5	1,904.8	4.8	137.8	103.9
2011	-1,225.2	-2,241.6	1,405.5	-3,647.1	664.5	608.9	1,912.5	4.4	140.3	100.9
2012	-978.0	-1,999.2	1,525.6	-3,524.8	675.3	647.9	1,972.5	4.7	139.0	108.2
2013	-1,035.1	-1,719.7	1,756.2	-3,475.9	543.8	923.2	2,015.3	4.7	140.3	105.7
2013 [8]	-1,037.1	-1,893.2	1,063.1	-2,956.3	543.8	-923.2	2,015.3	5.2	140.3	105.7
2014	-1,303.3	-2,136.6	924.2	-3,061.8	591.9	-801.3	2,191.7	5.5	140.0	105.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Source: Bank of Albania.

4. BILANCI FISKAL, STOKU I BORXHIT TË BRENDSHËM DHE BORXHI I JASHTËM NË MILIARDË LEKË

FISCAL BALANCE, DOMESTIC DEBT STOCK AND EXTERNAL DEBT 4. IN BILLIONS ALL

	Të Ardhura / Revenue	Nga të cilat: Të ardhura tatimore / Of which: Tax revenue	Shpenzime / Expenditure	Shpenzime kapitale / Capital expenditure	Deficiti / Deficit	Financim i brendshëm / Domestic financing	Financim i huaj / Foreign financing	Stoku i borxhit të Qeverisë Qendrore / Central government debt stock	
								Stoku i borxhit të brendshëm / Domestic debt stock	Stoku i borxhit të jashtëm / External debt stock
	1	2	3	4	5	6	7	8	9
2010	324.7	288.6	362.8	67.5	-38.0	13.2	24.9	407.4	308.0
2011	330.5	303.9	376.3	70.7	-45.8	26.1	19.8	438.6	333.9
2012	330.4	300.9	376.2	61.7	-45.9	26.5	19.4	470.4	357.6
2013	327.2	299.9	394.1	65.5	-66.9	56.1	10.8	520.8	363.9
2014	366.7	335.9	438.8	60.5	-72.1	42.2	29.9	564.7	412.4

Burimi: Ministria e Financave, sipas publikimeve "Statistikat fiskale, Janar-Dhjetor 2015" dhe Treguesit e Borxhit, 12 M 2014".
Publikimi 'Statistika fiskale Janar-Dhjetor 2015' tabelat:
Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (Vjetor).
"Burimi INSTAT : Llogaritë Kombëtare Vjetore; Llogaritë Kombëtare Vjetore (Metoda e prodhimit), sipas NVE Rev2 (tabela 1); Llogaritë Kombëtare Vjetore (Metoda e Shpenzimeve) (tabela gbi)"
Shënime:
1) Përfshihen vetëm llogaritë dhe depozitat që janë pjesë e parasë së gjerë.
2) Përfaqëson kredinë për ekonominë.
3) Norma mesatare e ponderuar vjetore e depozitave dhe kredive të reja 12 mujore në lekë për sistemin bankar.
4) Të dhënat i referohen normës në fund të periudhës.
5) PBB 2013 Gjysëm-finale.
"6) Të dhënat sipas informacionit në faqen e internetit të INSTAT datë 13.07.2015:
Temat/ Tregu i punës/ Anketa e Forcave të Punës/ Vjetore/ Shkalla e punësimit 2007-2014 (grupmosha 15-64 vjeç); Shkalla e papunësisë 2007-2014 (grupmosha 15-64 vjeç)."
7) Të dhënat 2010-2013 janë hartuar sipas manualit të pestë të pagesave.
8) Të dhënat janë hartuar sipas manualit të gjashtë të bilancit të pagesave.

Source: Ministry of Finance, according to "Fiscal Statistics, January-Dicember 2015" and "Debt Indicators, Dec.31, 2014" publications.
Publication 'Fiscal statistics January- December 2015' tables:
"Consolidated general budget (Annual)".
Source INSTAT: Annual National Accounts , Annual National Accounts (Production Method), by NACE Rev 2 (table 1); Annual National Accounts (Expenditure Method) (gbi table)
Footnote:
1) Deposits included in broad money.
2) Credit to economy.
3) The annual weighted average rate of the 12 months new deposits and loans in ALL for the banking system.
4) End of period data.
5) GDP 2013 Semi final.
"6) Data as of INSTAT web page tables, date 13.07.2015:
Figures/ Figures by theme/ Labour market/ Labour Force Survey/ Yearly/ Employment rate 2007-2013 (age group 15-64 years): Unemployment rate 2007-2013 (age group 15-64 years)."
7) The data 2010-2013 are compiled according to BPM5 IMF Manual.
8) Data presented are compiled according to BPM6 IMF Manual.

1. SEKTORI FINANCIAR
1-1 BILANCI SEKTORIAL I BANKËS SË SHQIPËRISË
NË MILIONË LEKË, FUND PERIUDHE

FINANCIAL SECTOR 1.
SECTORAL BALANCE SHEET OF BANK OF ALBANIA 1-1
IN MILLIONS ALL, END OF PERIOD

	Totali i mjeteve/ Total assets (2+3+4+5+8+12+13+14)	Ari monetar dhe mbajtjet e SDR*/ Monetary gold and SDR holdings*	Arka në valutë/ Foreign currency	Depozita/ Deposits	Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet / Securities other than shares (6+7)			Huatë/ Loans (9+10+11)				Derivatet financiare/ Financial derivatives	Llogari të arkëtueshme/ Receivable accounts	Mjete jofinanciare/ Nonfinancial assets
					Jorezidentë/ Nonresidents	Qeveria Qendrore/ Central Government		Qeveria Qendrore/ Central Government	Korporata të tjera depozituese/ Other depository corporations	Sektorë të tjerë rezidentë/ Other resident sectors				
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
2012 / 12	394,833.6	17,703.3	67.5	30,517.5	294,007.2	229,313.1	64,694.1	23,706.8	_	21,800.2	1,906.5	14.2	14,129.2	14,688.0
2013 / 12	398,813.6	16,701.5	57.3	23,892.8	308,387.0	243,178.6	65,208.4	23,333.2	_	21,502.3	1,830.9	31.5	11,994.1	14,416.4
2014 / 12	433,878.0	19,299.7	56.2	32,524.0	320,744.6	256,796.7	63,947.9	27,286.3	_	25,547.8	1,738.5	17.4	18,197.8	15,752.1
2014 / 12	433,878.0	19,299.7	56.2	32,524.0	320,744.6	256,796.7	63,947.9	27,286.3	_	25,547.8	1,738.5	17.4	18,197.8	15,752.1
2015 / 01	450,092.4	20,589.3	21.4	40,574.3	324,261.4	260,518.7	63,742.8	29,842.7	_	28,110.7	1,732.0	20.8	18,584.3	16,198.1
02	469,195.2	28,613.8	138.9	40,466.6	329,748.8	266,085.3	63,663.5	27,328.6	_	25,602.4	1,726.2	35.1	26,811.9	16,051.5
03	473,891.3	29,254.8	30.7	40,284.8	332,379.1	269,169.1	63,210.0	30,334.6	_	28,615.3	1,719.3	34.5	25,478.7	16,094.2
04	465,272.1	28,371.3	134.7	39,204.1	322,845.7	259,689.7	63,156.0	33,608.5	_	31,897.3	1,711.2	51.8	25,003.1	16,052.9
05	474,884.3	33,915.0	15.4	40,137.8	324,267.5	261,156.8	63,110.7	27,268.3	_	25,564.1	1,704.2	61.4	33,151.0	16,067.9

	Detyrimet totale/ Total liabilities (2+3+4+10+14+15+16)	Paraja në qarkullim/ Currency in circulation	Depozita të përfshira në paranë e gjerë/ Deposits included in broad money	Depozita të papërfshira në paranë e gjerë/ Deposits excluded from broad money (5+6+7+8+9)						Huatë / Loans (11+12+13)				Llogari të pagueshme/ Other accounts payable	Alokimi i SDR/ SDR allocation	Aksione dhe instrumente të tjera të kapitalit/ Shares and other equity
					Jorezidentët/ Nonresidents	Qeveria Qendrore/ Central Government	Korporata të tjera depozituese/ Other depository corporations	Korporata të tjera jofinanciare/ Other nonfinancial corporations	Sektorë të tjerë rezidentë/ Other resident sectors		Jorezidentët/ Nonresidents	Qeveria Qendrore/ Central Government	Korporata të tjera depozituese/ Other depository corporations			
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
2012 / 12	394,833.6	200,898.7	187.3	120,691.0	10,042.9	12,887.1	97,054.7	37.2	669.2	3,870.7	3,870.7	_	_	1,680.5	7,557.9	59,947.5
2013 / 12	398,813.6	207,792.7	249.7	132,764.9	9,706.5	22,239.2	100,031.3	62.5	725.4	2,919.3	2,919.3	_	_	1,828.3	7,287.5	45,971.3
2014 / 12	433,878.0	226,434.1	154.2	140,569.3	16,564.1	16,600.5	106,310.9	85.0	1,008.8	2,294.2	2,294.2	_	_	889.8	7,753.2	55,783.2
2014 / 12	433,878.0	226,434.1	154.2	140,569.3	16,564.1	16,600.5	106,310.9	85.0	1,008.8	2,294.2	2,294.2	_	_	889.8	7,753.2	55,783.2
2015 / 01	450,092.4	224,009.7	130.5	150,650.8	16,539.3	25,807.3	107,347.1	86.3	870.8	2,293.6	2,293.6	_	_	1,096.3	8,073.6	63,837.9
02	469,195.2	226,134.3	161.4	165,262.1	23,890.0	24,437.0	115,895.8	94.5	944.8	2,152.6	2,152.6	_	_	1,759.9	8,209.0	65,515.9
03	473,891.3	225,389.5	1,028.5	166,574.6	23,874.1	29,714.7	112,030.3	94.4	861.1	2,102.8	2,102.8	_	_	1,648.8	8,395.2	68,752.0
04	465,272.1	225,811.0	3,078.5	160,706.5	23,853.4	28,773.8	107,114.2	94.5	870.5	2,059.7	2,059.7	_	_	289.1	8,152.1	65,175.3
05	474,884.3	231,282.0	1,621.0	163,455.8	31,938.2	25,411.2	105,242.6	93.3	770.4	2,078.1	2,078.1	_	_	524.8	8,293.6	67,629.1

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania.

1-2 PARAQITJA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË NË MILIONË LEKË, FUND PERIUDHE

MONETARY SURVEY OF BANK OF ALBANIA 1-2 IN MILLIONS ALL, END OF PERIOD

	Mjete valutore neto/ Net foreign assets (2-3)	Pretendime ndaj jorezidentëve/ Claims on nonresidents	Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve/ Less: Liabilities to nonresidents	Mjetet e brendshme / Domestic assets (5+8+9+10+11+12)	Pretendime neto ndaj Qeverisë Qendrore/ Net claims on Central Government (6-7)	Pretendime ndaj Qeverisë Qendrore/ Claims on Central Government	Minus: Detyrime ndaj Qeverisë Qendrore/ Less:Liabilities to Central Government	Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese/ Claims on other depository corporations	Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare/ Claims on other financial corporations	Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike / Claims on public nonfinancial corporations	Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare/ Claims on other nonfinancial corporations	Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë/ Claims on other resident sectors
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
2012 / 12	266,540.0	288,142.1	21,602.1	78,858.1	55,145.6	68,057.8	12,912.2	21,800.8	_	_	_	1,911.7
2013 / 12	274,198.2	294,111.3	19,913.2	67,841.8	44,503.1	66,768.8	22,265.7	21,502.9	_	_	_	1,835.8
2014 / 12	292,098.3	318,940.2	26,841.9	82,525.1	55,198.3	71,831.3	16,633.0	25,547.8	_	_	37.3	1,741.7
2014 / 12	292,098.3	318,940.2	26,841.9	82,525.1	55,198.3	71,831.3	16,633.0	25,547.8	_	_	37.3	1,741.7
2015 / 01	304,919.7	332,347.1	27,427.4	75,655.1	45,767.4	71,633.6	25,866.2	28,110.7	_	_	41.5	1,735.5
02	310,980.2	346,806.1	35,825.9	81,792.0	54,418.0	78,940.0	24,522.0	25,602.4	_	_	41.4	1,730.2
03	314,436.3	349,332.6	34,896.3	77,731.6	47,350.5	78,059.0	30,708.5	28,615.3	_	_	41.9	1,724.0
04	303,394.3	337,586.5	34,192.3	82,786.8	49,173.2	78,001.2	28,828.0	31,897.3	_	_	_	1,716.3
05	303,895.3	346,592.2	42,696.9	86,758.9	59,472.9	84,924.0	25,451.1	25,564.1	_	_	14.8	1,707.2

	Baza monetare/ Monetary base (14+15+16)	Paraja në qarkullim/ Currency in circulation	Detyrime ndaj korporatave të tjera depozituese/ Liabilities to other depository corporations	Depozita të përfshira në paranë e gjerë/ Deposits included in broad money	Depozita të papërfshira në paranë e gjerë/ Deposits excluded from broad money	Huatë/ Loans	Llogari të pagueshme/ Other accounts payable	Të tjera neto/ Other items net	Aksione dhe instrumente të tjera të kapitalit/ Shares and other equity
	13	14	15	16	17	18	19	20	21
2012 / 12	297,721.9	200,898.7	96,635.9	187.3	1,125.1	_	1,306.1	-14,702.6	59,947.5
2013 / 12	308,073.7	207,792.7	100,031.3	249.7	787.9	_	1,309.8	-14,102.8	45,971.3
2014 / 12	332,899.3	226,434.1	106,310.9	154.2	1,093.8	_	14.8	-15,167.6	55,783.2
2014 / 12	332,899.3	226,434.1	106,310.9	154.2	1,093.8	_	14.8	-15,167.6	55,783.2
2015 / 01	331,487.2	224,009.7	107,347.1	130.5	957.1	_	26.1	-15,733.5	63,837.9
02	342,191.5	226,134.3	115,895.8	161.4	1,039.3	_	8.9	-15,983.5	65,515.9
03	338,448.3	225,389.5	112,030.3	1,028.5	955.5	_	29.2	-16,017.0	68,752.0
04	336,003.7	225,811.0	107,114.2	3,078.5	965.0	_	17.9	-15,980.9	65,175.3
05	338,145.6	231,282.0	105,242.6	1,621.0	863.7	_	10.2	-15,994.4	67,629.1

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Source: Bank of Albania.

1-3A BILANCI SEKTORIAL I BANKAVE PARADEPOZITUESE/ MJETET
NË MILIONË LEKË, FUND PERIUDHE

SECTORAL BALANCE SHEET OF DEPOSIT MONEY BANKS/ ASSETS 1-3A
IN MILLIONS ALL, END OF PERIOD

	Totali i mjeteve/ Total assets (2+3+4+8+11+21+24+25+26)	Arka në lekë/ National currency	Arka në valutë/ Foreign currency	Depozita/Deposits (5+6+7)				Letra me vlerë të ndryshme nga aksionet/ Securities others than shares (9+10)		
					Jorezidentët/ Nonresidents	Banka Qendrore/ Central Bank	Bankat paradepozituese/ Deposit money banks		Jorezidentët/ Nonresidents	Qeveria Qendrore/ Central Government
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
2012 / 12	1,235,866.3	8,177.0	10,928.2	225,802.8	122,169.4	97,304.4	6,329.0	355,507.8	51,037.8	304,470.0
2013 / 12	1,300,471.2	8,890.4	11,328.9	249,448.4	139,446.8	103,932.0	6,069.6	390,569.2	66,157.5	324,411.7
2014 / 12	1,354,708.0	8,765.4	11,055.4	245,965.9	130,183.8	106,632.0	9,150.1	424,283.6	87,349.5	336,934.2
2014 / 12	1,354,708.0	8,765.4	11,055.4	245,965.9	130,183.8	106,632.0	9,150.1	424,283.6	87,349.5	336,934.2
2015 / 01	1,358,935.2	8,963.1	11,380.8	239,576.2	125,112.0	109,558.4	4,905.8	433,486.5	94,713.0	338,773.5
02	1,366,961.6	8,840.7	10,239.5	246,415.3	122,236.0	118,721.6	5,457.7	430,796.3	92,663.5	338,132.9
03	1,375,092.9	8,970.5	10,690.7	253,415.8	135,768.4	112,311.8	5,335.6	423,861.4	83,212.8	340,648.6
04	1,373,791.8	8,540.5	10,145.5	262,662.4	150,005.9	107,228.6	5,427.9	420,050.4	77,641.8	342,408.6
05*	1,376,148.7	8,632.2	11,114.8	265,739.4	150,011.4	110,194.3	5,533.8	414,724.9	75,501.6	339,223.3

	Huatë/ Loans (12+13+14+15+16 +17+18+19+20)										Aksione dhe instrumente të tjera të kapitalit / Shares and other equity (22+23)			Derivatet financiare/ Financial derivatives	Llogari të Arkëtueshme/ Other accounts receivable	Mjete jofinanciare/ Nonfinancial assets
		Jorezidentët/ Nonresidents	Banka Qendrore/ Central Bank	Bankat paradepozituese/ Deposit money banks	Korporata të tjera financiare/ Other financial corporations	Qeveria Qendrore/ Central Government	Qeveria lokale / Local government	Korporata jofinanciare publike / Public nonfinancial corporations	Korporata të tjera jofinanciare/ Other nonfinancial corporations	Sektorë të tjerë rezidentë/ Other resident sectors		Jorezidentët/ Nonresidents	Rezidentë/ Residents			
	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26
2012 / 12	598,545.9	45,050.3	_	3,856.4	10,162.9	1,397.5	193.9	23,780.6	370,993.0	143,111.2	4,327.9	4,026.0	301.9	_	6,335.3	26,241.4
2013 / 12	593,625.3	43,698.9	_	6,787.2	9,578.2	1,404.4	256.0	24,961.0	363,541.1	143,398.5	5,123.1	4,753.0	370.1	_	8,138.8	33,347.1
2014 / 12	614,230.0	53,447.7	_	6,011.6	8,270.3	1,263.2	777.7	27,328.2	372,166.6	144,964.8	5,858.9	5,020.0	838.9	_	7,551.9	36,997.0
2014 / 12	614,230.0	53,447.7	_	6,011.6	8,270.3	1,263.2	777.7	27,328.2	372,166.6	144,964.8	5,858.9	5,020.0	838.9	_	7,551.9	36,997.0
2015 / 01	613,653.8	56,381.4	_	4,817.8	8,237.3	1,260.8	769.0	28,250.8	368,219.1	145,717.7	6,377.8	5,539.4	838.4	_	8,326.3	37,170.8
02	618,873.4	61,998.9	_	5,378.6	8,041.7	1,263.5	767.3	27,330.5	367,939.3	146,153.6	6,477.9	5,638.7	839.2	_	8,243.5	37,075.0
03	626,657.2	68,214.2	_	6,406.5	7,950.5	1,264.8	862.6	28,188.8	365,598.1	148,171.7	6,743.9	5,904.7	839.1	_	7,794.8	36,958.8
04	620,654.1	65,896.6	_	3,635.3	8,185.3	1,127.0	855.4	26,958.6	366,626.0	147,370.0	6,646.0	5,786.0	860.0	_	8,346.4	36,746.6
05	624,123.3	64,492.7	0.6	5,207.5	8,131.7	1,128.1	875.4	26,931.2	369,380.5	147,975.8	6,675.9	6,039.4	636.5	_	8,454.1	36,684.0

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania.

1-3B BILANCI SEKTORIAL I BANKAVE PARADEPOZITUESE/ DETYRIMET NË MILIONË LEKË, FUND PERIUDHE

SECTORAL BALANCE SHEET OF DEPOSIT MONEY BANKS/ LIABILITIES 1-3B IN MILLIONS ALL, END OF PERIOD

